

**Komiteti për
Marrëdhëniet
ndërmjet Bashkësive:
20 VITE MUNDËSI DHE
SFIDA TË
PA(SHFRYTËZUARA)**

KOMITETI PËR MARRËDHËNIET NDËRMJET BASHKËSIVE:

20 vite mundësi dhe sfida të pa(shfrytëzuara)



Projekti është
i financuar
nga Bashkimi
Evropian



МАКЕДОНСКИ
ЦЕНТАР ЗА
МЕЃУНАРДОНА
СОРАБОТКА

МЦМС

Botues: **Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar**

Për botuesin: **Aleksandar Kërzhallovski, drejtor i QMBN –së**

Redaktor: **prof. dr Rubin Zemon**

Autorë: **prof.dr. Ana Çupeska**

prof.dr. Rizvan Sulejmani

prof.dr. Rubin Zemon

Lekturoi: **Daniell Medarovski**

Përkthimi nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe: **Vjosa Taipi**

Dizajni grafik: **Kontura SHPK**

Shtypi: **Kontura SHPK**

Tirazhi: **100**

Skopje, 2024

Ky hulumtim është përgatitur me mbështetjen e Bashkimit Evropian për nevojat e projektit “Komisioni Kundër Diskriminimit kryen rolin e tij parandalues dhe mbrojtës”. Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi e vetme e autoreve dhe jo domosdoshmërisht pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara, riprodhimi, kopjimi, transmetimi ose përkthimi i cilës do pjesë të këtij hulumtimi mund të bëhet vetëm në kushtet e mëposhtme: me leje paraprake të botuesve, për qëllime të citimit në analizë të librit dhe sipas kushteve të përcaktuara më poshtë.

Të drejtat e autorit në këtë hulumtim janë mbrojtur, por hulumtimi mund të riprodhohet në cilën do qoftë mënyrë dhe pa pagesë për qëllime edukative. Për kopjim në kushte të tjera, për përdorim në hulumtime të tjera ose për përkthim ose adaptim, duhet të sigurohet leje paraprake nga botuesi.

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека «Св. Климент Охридски», Скопје

35.075.2:323.1]:342.53(497.7)»2002/2022»

ЧУПЕСКА, Ана

Комитет за односи меѓу заедниците : 20 години (не)искористени можности и предизвици / [автори Ана Чупеска, Ризван Сулејмани, Рубин Земон ; превод од македонски на албански јазик Вјоса Таипи]. - Скопје :

Македонски центар за меѓународна соработка (МЦМС), 2024. - 45, 44 стр. :
граф. прикази ; 21 см

Насл. стр. на припечатениот текст: Комитети për marrëdhëniet ndërmjet bashkësive : 20 vite mundësi dhe sfida të pa (shfrytëzuara) / autorë:

Ана Чупеска, Ризван Сулејмани, Рубин Земон. - Обата текста меѓусебно печатени во спротивни насоки. - Текст на мак. и алб. јазик. - Белешка за

авторите: стр. 45 ; Shënim për autorët: стр. 44. - Фусноти кон текстот.

- Библиографија: стр. 43-44 ; Bibliografia: стр. 42-43

ISBN 978-608-4848-56-1

1. Сулејмани, Ризван [автор] 2. Земон, Рубин [автор]

а) Комитет за односи меѓу заедниците -- Собрание -- Македонија --
2002-2022

COBISS.MK-ID 62846213

PËRMBAJTJA

REZYME EKZEKUTIVE	7
REKOMANDIMET KRYESORE	8
PARATHËNIE	9
Komiteti për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive në sistemin e akomodimit multikulturor të Republikës së Maqedonisë së Veriut prof.dr. Ana Çupeska, Universiteti "Shën Cirili dhe Metodi, Shkup	11
Struktura juridiko-politike e Komitetit për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive	11
SFIDAT	13
Rekomandime	15
Komiteti për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive si avangardë e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit Prof. dr. Rizvan Sulejmani, Universiteti "Nëna Tereza", Shkup	18
Natyra e konfliktit të vitit 2001 – pasojat	18
Marrëveshja Kornizë e Ohrit – Baza për rregullim të ri të sistemit politik	19
Komiteti për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive (KMNB) – baza juridike	20
Puna e deritanishme të Komitetit për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive	21
Rezyme përfundimtare	27
Rekomandimet	28
Aspekti multikulturor i punës prof. dr. Rubin Zemon, Qendra për Kërkime të Avancuara, Shkup	31
Vështrim i shkurtër mbi teoritë dhe politikat multikulturore	31
Komiteti për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive në kornizën ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të pakicave	33
Trupa të ngjashme në vendet e rajonit	35
Komiteti për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive (analiza historike-cilësore)	36
Konkluzion dhe rekomandime	40
Shënim për autorët	44



REZYME EKZEKUTIVE

Konteksti nga i cili lindi ideja e Komitetit për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive (KMNB), konflikti ushtarak i vitit 2001 dhe Marrëveshja Kornizë e Ohrit, nuk duhet të jetë barrë për të **vlerësuar në mënyrë objektive dhe reale rolin e këtij trupi të përhershëm**, për funksionimin e demokracisë parlamentare në një shoqëri multikulturore dhe në një shtet qytetar.

Nga analiza e legjislacionit aktual i cili e rregullon punën e KMNB-së, Ligjit për Komitetin për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive, mund të konstatohet se nuk e përpunon plotësisht dispozitën kushtetuese që del nga Amendamenti XII i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Gjithashtu, analiza e raporteve për punën e KMNB-së në periudhën 2002-2022 na jep të drejtën të konstatojmë se përfaqësuesit e popullit nuk e njohin rolin kryesor të këtij trupi për ndërtimin e një demokracie multietnike.

Numri i mbledhjeve të mbajtura dhe pikat që janë shqyrtuar tregojnë se Komiteti nuk ka arritur të imponohet si trup i posaçëm i përhershëm kryesor i cili është i rregulluar me Ligjin, gjë që i jep një peshë specifike që nuk e kanë komisionet dhe trupat e tjera të përhershme të Kuvendit.

Analiza e detajuar tregon gjithashtu se puna e këtij trupi varet drejtpërdrejt nga rrethanat dhe kontekstet politike, e veçanërisht nga angazhimi i Kryetarit të Komitetit.

Duhet theksuar se në 20 vitet e funksionimit të Komitetit për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive, të gjithë kryetarët(et) kanë qenë nga komuniteti etnik shqiptar. Ky fakt tregues tregon se ky funksion duket sikur është rezervuar vetëm për një komunitet.

Gjithashtu mund të thuhet se kontributi i Komitetit për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive në avancimin e marrëdhënieve ndëretnike është i parëndësishëm. Ky konkluzion bazohet, para së gjithash, në faktin se Kuvendi nuk ka vepruar sipas konkluzioneve të Komitetit. Ndikimi i partive politike dhe politikave të tyre është dominues, ndërsa përkatësia partiake dhe të qenët konsekuent në ndjekjen e direktivave partiake e përcakton punën e deputetëve si anëtarë të Komitetit për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive.

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi Konkluzione lidhur me pikat 3 dhe 4 të Konkluzioneve të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe pikën 11 të Qëndrimit të përbashkët të Bashkimit Evropian të miratuara në Mbledhjen politike të Konferencës ndërqeveritare për anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian, të mbajtur më datë 19.7.2022, sipas të cilave ka ndërmarrë obligim edhe për amendamentet kushtetuese. Meqë këto amendamente kushtetuese e targetojnë përbërjen numerike të KMNB-së, është e dukshme se sfida kryesore për punën e tij përbën pikërisht qasja në amendamentet kushtetuese.

KMNB-ja, përveç që është përfaqësues thelbësor dhe faktik për faktin e multikulturalizmit shoqëror maqedonas, ai është edhe organ/trup i cili ka interes të veçantë **të mbështetet**

nga të gjithë aktorët politikë, për shkak të natyrës së funksionit të tij. Së këndejmi, përforsimi i tij funksional, operativ dhe administrativ është më se i nevojshëm.

REKOMANDIMET KRYESORE

1. Të përforsohet pozita e KMNB-së në Kuvend si trup i posaçëm i cili **do të jetë në punime të përhershme për t'i monitoruar marrëdhëniet ndëretnike** në shtet. Ndërhyrjet në Ligj duhet të sigurojnë **kritere, standarde dhe kornizë kohore për dinamikën e punës** së KMNB-së, në mënyrë që aktiviteti të mos varet nga personi që e kryen funksionin e kryetarit.
2. Puna e Komitetit duhet të vihet në **rolin e zbulimit dhe parandalimit të hershëm të raporteve të cenuara ndëretnike**, në vend të zgjidhjes, e së paku në rolin vetëm e "shuarjes së pikave të nxehta
3. Që të përmirësohet funksionimi i Komitetit për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive, duhet të shqyrtohen çështjet për **kufizimin e ndikimit politik mbi Komitetin**, si dhe **rritjen e përfshirjes së komuniteteve etnike në numër të vogël**.
4. Në funksion të rritjes së rolit të tyre Komiteti doemos duhet të ketë mbështetje të tij **të veçantë profesionale administrative**, në të cilën sipas nevojës do të përfshihen **ekspertë dhe punëtorë shkencorë**.
5. Ndryshimet në **Kodin Zgjedhor** që **t'u mundësohet bashkësive më të vogla etnike të zgjedhin përfaqësues në Kuvend**. Kjo mund të garantojë mendime të ndryshme në bazë të strukturës etnike në shoqërinë, pavarësisht vullnetit të elitave politike të koalicionit. Mundësi tjetër janë **vendet e rezervuara në Kuvend**, të cilat u mundësojnë bashkësive etnike të kenë përfaqësim në shtëpinë legjislative, pavarësisht rezultatit të zgjedhjeve parlamentare.
6. Në të ardhmen, Komiteti duhet të tregojë vullnet më të madh politik për t'u angazhuar në një **debat të hapur dhe konstruktiv për çështje të ndjeshme etnike**.
7. Neni 6 i Ligjit për Komitetin i cili përcakton se **kryetari** zgjidhet çdo vit me **parimin e rotacionit**, **duhet të fillojë të respektohet**, gjë që do të rezultojë me diversitet etnik në këtë funksion, e me këtë do të ketë një demokraci dhe diversitet më të madh në një debat të hapur konstruktiv për çështje të ndjeshme etnike.

Viti aktual 2023 është jubilar, veçanërisht për disa dokumente dhe instrumente të rëndësishme politike në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare dhe për zhvillimin e multikulturalizmit në korniza ndërkombëtare, por edhe në vendin tonë, Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Gjegjësisht, para 25 vitesh, në Këshillin e Evropës hyri në fuqi Konventa kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare, kur u bë pjesë e legjislationit maqedonas. Ndërsa para 20 vitesh u mbajt mbledhja e parë konstituive e Komitetit për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive (KMNB). Si produkt i Marrëveshjes kornizë të Ohrit dhe amendamenteve kushtetuese të vitit 2001, ky organ i përhershëm i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në një farë mënyre duhet t'i artikulojë të drejtat kolektive, ose të drejtat specifike grupe të pjesëtarëve të bashkësive joshumicë në vendin tonë, nevojat dhe kërkesat e tyre, kjo në kontekst të sistemit liberal-demokratik politik, multikulturalizmit, lidhur me shoqërinë maqedonase. Me Amendamentin XII të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, përcaktohet se Komiteti i shqyrton çështjet e marrëdhënieve ndërmjet bashkësive në Republikën dhe jep mendime dhe propozime për zgjidhjen e tyre, me çka theksohet dukshëm roli ndërkulturor i këtij trupi.

Agjenda politike maqedonase për vitin 2023 ishte disi e « preokupuar » me nevojën që Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut të pësojë ndryshime, me qëllim vazhdimin e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian, pas përfundimit të procesit të “skringut”. Më konkretisht, kushti është që në Preambulën e Kushtetutës të përfshihen edhe bashkësi të tjera, përkatësisht pjesë të popujve, që shfaqin interes dhe në një farë mënyre i plotësojnë kriteret për këtë. Qeveria e RMV-së, pas një debati të mëparshëm dhe rekomandimit të Komisionit që e themeloi për propozimin e amendamenteve kushtetuese, i propozoi Kuvendit se duhet t'i qaset procedurës për ndryshimin e Kushtetutës, duke plotësuar Preambulën në pjesën e emërimit të «pjesëve të kombeve», që të shtohen edhe «bullgarët, kroatët, malazezët, sllovenët, hebrenjtë dhe egjiptianët». Gjithashtu, duhet të bëhen ndryshime në Amendamentin XII, i cili i referohet nenit 78 të Kushtetutës, në pjesën e përbërjes së Komitetit për marrëdhënie ndërmjet Bashkësive, duke shtuar një anëtar nga secila prej Bashkësive të përmendura.

Këto ngjarje, 20 vite nga mbledhja e parë e KMNB-së dhe propozimi për ndryshimet kushtetuese, në një farë mënyre e vendosën Komitetin në fokusin e mendimit politik dhe ekspert, me ç'rast natyrshëm u parashtruan pyetje nëse ky organ i përhershëm në Kuvendin e RMV-së është me të vërtetë një “gur pengese”, që e ardhmja e BE-së të varet nga integritet e vendit, nëse ka funksion dhe rol kaq të rëndësishëm në sistemin politik, si dhe nëse ndryshimet kushtetuese do të shkaktojnë “turbulenca” të mëdha në politikë dhe në jetën multikulturore?

Së këndejmi, legjitime janë pyetjet lidhur me atë se cili ka qenë ndikimi i KMNB-së në ndërtimin e marrëdhënieve ndëretnike, në parandalimin e konflikteve, në ndërtimin e

politikave lidhur me mbrojtjen e të drejtave të bashkësive dhe multikulturalizmin ose ndërkulturalizmin në vend? Andaj, ky publikim ka për qëllim të japë kontribut në atë drejtim. Gjithashtu, gjatë analizës së punës dhe ndikimit të KMNB-së, autorët njoftuan, ose një fakt shumë i pazakontë, se përkundër faktit se KMNB-ja është një kategori kushtetuese me historinë e saj 20-vjeçare, megjithatë nuk ka ndonjë hapësirë adekuate ose e përhershme publike në të cilin do të ruhej e a.q. **memoria dhe trashëgimia institucionale e këtij institucioni të rëndësishëm. Një shtet demokratik, qytetar i cili me Kushtetutë i afirmon politikat multikulturore dhe ndërkulturore, jemi të bindur se duhet të ketë edhe një memorie institucionale adekuate të trupit më të lartë në sistemin politik në pjesën e marrëdhënieve ndëretnike, siç është KMNB-ja. Ky botim në njëfarë mënyre përbën edhe përpjekje në atë drejtim, që të lihet gjurmë në memorien institucionale multikulturore dhe ndërkulturore maqedonase, që do t'u shërbejë gjeneratave aktuale dhe të ardhshme të politikanëve, si dhe anëtarëve të KMNB-së.**

Duke e pasur parasysh këtë autorët në veçanti fokusohen në strukturën juridiko-politike të KMNB-së, aspektin historik të punës së KMNB-së, kontekstin lokal të Marrëveshjes së Ohrit, rolin e KMNB-së në zhvillimin e marrëdhënieve ndëretnike, aspektin multikulturore të punës së KMNB-së, përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e pakicave kombëtare, krahasimin me punën me trupat e ngjashme në rajonin, përcaktimin e sfidave dhe pengesave, si dhe rekomandimet për tejkalimin e tyre.

Dëshirojmë të shprehim falënderim ndaj Institutit parlamentar të Kuvendit të RMV-së, i cili ka përgatitur disa analiza referuese lidhur me punën e KMNB-së, por me kërkesë të deputetëve në periudhën e kaluar. Ato analiza na i dorëzuan për t'i pasur në dispozicion.

Falënderim të veçantë ndaj Qendrës Ndërkombëtare për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QNBN), që qëndroi pas këtij projekti dhe që e mbështeti financiarisht botimin e tij.

KOMITETI PËR MARRËDHËNIE NDËRMJET BASHKËSIVE NË SISTEMIN E AKOMODIMIT MULTIKULTUROR TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

PROF.DR. ANA ÇUPESKA, UNIVERSITETI "SHËN CIRILI DHE METODI, SHKUP

STRUKTURA JURIDIKO-POLITIKE E KOMITETIT PËR MARRËDHËNIE NDËRMJET BASHKËSIVE

Republika e Maqedonisë nga viti i pasluftës 2001, diversitetin e tij kulturor e ka etabluar në nivel të sistemit politik konkret, në drejtim të afirmimit të konceptit të multikulturalizmit liberal (Kimlicka W. 2017; Çupeska S.A., 2017), e me atë vendoset në shtetet që nuk kanë tendencë për ta hemogjinizuar popullatën e tyre me diversitet kulturor.

Me fjalë të tjera, institucionet e Maqedonisë së Veriut e pranojnë faktin se shoqëria është multikulturore, dhe si rrjedhojë e kësaj, fakti i tillë shoqëror konkretizohet dhe materializohet në nivel të sistemit politik konkret. Më konkretisht, modeli maqedonas i rregullimit të diversitetit kulturor është veçanërisht i natyrës joterritoriale, ndërsa mbështetet në argumentet shkencore lidhur me të a.q. gjeneratë e dytë të përgjigjeve liberale-demokratike ndaj diversitetit kulturor (që mund të përcillet prapa deri te Xhon Rrolls, Xhon Grej, Riçard Rorti, mes tjerash), por që e marrin parasysh edhe argumentin komunitar, për shembull, Çarls Tejllor dhe Aleksandar Mekintajr, Vill Kimllcka, Ijris Majaron Jang etj. Në atë kuptim, që në fillim ia vlen të potencohet edhe ajo se në esencë kur flasim për modelin maqedonas të akomodimit multikulturor, nënkuptohet i a.q. modeli multikulturor normativ, i cili para së gjithash i nënkupton moduset operative normative, në pajtim me të cilat identitetet e ndryshme grupe kulturore mund të prezantohen në nivel normativ dhe institucional (Çupeska&Rajčinovska: 2022), si dhe ende më e rëndësishme në këtë kontekst, norma, e jo territori është ajo e cila e mundëson inkluzionin e grupeve. Si rrjedhojë, modeli maqedonas i akomodimit multikulturor bën pjesë në llojet joterritoriale. Si i tillë – joterritorial, bazohet në tre shtylla kryesore:

- I. Të drejtat specifike grupe dhe përfaqësimi i garantuar;
- II. Ndarja e fuqisë (power-sharing) dhe konsolidimi;
- III. Akomodimi multikulturor simbolik.

Përmes këtyre shtyllave, modeli maqedonas përjashton çfarëdo lloj të zgjidhjes territoriale për dallimet identike kulturore, për shembull, në lloj të etno-federatave, konfederatave etj. (Çupeska S.A., 2017).

Grupet kulturore, veçanërisht pakicat etnike, gjithandej nëpër botë, ndaj institucioneve dhe organeve shtetërore, si dhe proceset e miratimit të vendimeve politike, shpesh vendosin kërkesa në formatin e të a.q. përfaqësimit të garantuar (guaranteed representation)¹. Edhe sistemi politik maqedonas, me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit,

¹ Mekanizmat e këtyre llojeve mund të variojnë. Për shembull, tre prej nëntë vendeve në gjykatat supreme

pas vitit 2001, gjithashtu parasheh moduse për përfaqësim të garantuar. Në pajtim me rregullat kushtetuese, përfaqësimi i bashkësive etnike në institucionet e Maqedonisë së Veriut, realizohet në më shumë nivele dhe përmes disa shtyllave (për të cilat u përmend më lartë), si dhe përmes kuotave për regjistrime, pastaj te zgjedhjet, e veçanërisht përmes zbatimit të të a.q. "Parimi i Badenterit" me të cilin mundësohet përfaqësimi i garantuar gjatë votimit në Parlament. Por, parimi i përfaqësimit të garantuar zbatohet edhe te zgjedhja e gjykatësve në Gjykatën Kushtetuese, Këshilli i Sigurisë, Këshilli Gjyqësor, Avokatit të Popullit etj., Megjithatë, është veçanërisht interesant zbatimi i parimit të përfaqësimit të garantuar në Komitetin për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive (KMNB), i cili në mënyrë shumë unike e siguron përfaqësimin e grupeve të ndryshme kulturore, i cili njëkohësisht është edhe kompetent për të vendosur në rast të kontestit, lidhur për zbatimin e rregullit "të badenterit".

KMNB-ja u formua me Marrëveshjen Kornizë 2001, e pas ndryshimit të Kushtetutës nga viti 1991. Si organ i cili është i lidhur drejtpërdrejt me vendosjen e parimit për përfaqësim të garantuar (guaranteed representation) gjë që është padyshim kusht kryesor për demokraci inkluzive në shoqërinë heterogjene etnike, KMNB-ja është veçanërisht organ aktual i cili operon në kuadër të shtëpisë legjislative të Maqedonisë. Së këndejmi, ai në mënyrë të arsyetuar është me interes të veçantë si për publikun shkencor, ashtu edhe për publikun më të gjerë dhe profesional. Por, siç mund të vërejmë, kohët e fundit, bëhet objekt edhe i afirmimit politik.

Më parë ekzistonte trup i ngjashëm: Këshilli për Marrëdhënie Ndërkombëtare², por Komiteti i sapoformuar, në kushte të vendosjes së drejtësisë etnokulturore, në një mënyrë krejtësisht tjetër, jep kontribut në akomodimin e dallimeve dhe atë në pajtim me parimet e multikulturalizmit liberal.

Gjegjësisht, Komiteti i cili është themeluar nga Kuvendi, mund të konsiderohet për variant maqedonas unik i ndarjes së fuqisë/pushtetit (power sharing) në pushtetin legjislativ i cili është rezultat i përfaqësimit të garantuar (guaranteed representation) të bashkësive, më saktësisht është rezultat i angazhimeve kushtetuese për garantimin e inkluzivitetit në praktikimin e pushtetit publik.

Nga kjo perspektivë, njëra vërejtje profesionale do të jetë se përmes praktikimit të parimit për përfaqësim të garantuar në fakt realizohet edhe ndarja e fuqisë/pushtetit. Është specifike që, institucioni i tillë nuk ekziston askund në botë dhe origjinaliteti i Komitetit për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive shihet pikërisht në atë që ai përveç që vendoset sipas parimit të përfaqësimit të garantuar për shkak

kanadeze janë rezervuar për studime në Kebek, ndërsa maurët garantojnë përfaqësim në parlamentin e Zelandës së Re. Njëjtë;

² Para ndryshimeve në Kushtetutë, neni 78 thoshte: "Kuvendi themelon Këshillin për Marrëdhënie Ndërkombëtare". Këshilli përbëhet nga: Kryetari i Kuvendit dhe dy anëtarë nga maqedonasit, shqiptarët, turqit, vllahët, romët dhe dy anëtarë nga kombësitë tjera në Maqedoni. Kryetari i Kuvendit është Kryetar i Këshillit. Kuvendi i zgjedh anëtarët e Këshillit. Këshilli shqyrton çështjet e marrëdhënieve ndërkombëtare në Republikë dhe jep mendime dhe propozime për zgjidhjen e tyre. Kuvendi është i detyruar t'i shqyrtojë mendimet dhe propozimet e Këshillit dhe të marrë vendim lidhur me to"; Shih në: <http://www.sobranie.mk/ustav-na-rm.nspx>

të sigurimit të ndarjes së fuqisë/pushtetit, njëkohësisht është edhe garant për inkluzionin në duart e bashkësive që jetojnë në Maqedoni. Komiteti prandaj, sipas Kushtetutës, është paraparë që të ketë 19 anëtarë nga të cilat maqedonasit dhe shqiptarët marrin pjesë me nga 7 anëtarë, ndërsa me nga 1 anëtar marrin pjesë turqit, vllahët, romët, serbët dhe boshnjakët. Kështu, sigurohet se bashkësitë kulturore-identitare joshumicë në Maqedoni kanë shumicë në këtë trup të Kuvendit. Esenca e këtij raporti proporcional, është faktikisht që të parandalojë majorizim dhe dominim kulturor.

Përveç kësaj, amendamenti XII ka paraparë se nëse ndonjë prej bashkësive nuk ka deputetë të saj në parlamentin, Avokati i Popullit, pas konsultimeve me përfaqësues relevantë të atyre bashkësive, do t'i propozojë ato në KMNB.

Megjithatë, kompetenca kryesore e Komitetit është që t'i shqyrtojë çështjet për marrëdhënie ndërmjet bashkësive dhe të japë propozime për zgjidhjen e tyre, ndërsa Kuvendi është i detyruar që t'i shqyrtojë dhe të sjellë vendime lidhur me to. Dhe ajo që është më e rëndësishme, vendos në rast të kontestit lidhur me zbatimin e procedurës për votim sipas "Badenterit" në Kuvend (neni 69 paragrafi 2) me shumicë votash të anëtarëve, më konkretisht, lidhur me atë nëse do të zbatohet ose nuk do të zbatohet procedura.

Si përfundim, parimi i përfaqësimit të garantuar, në të cilin është bazuar Komiteti, në fakt shpie në ndarjen e fuqisë ndërmjet "bashkësive joshumicë" në kuadër të procesit legjislativ. Ky është veçanërisht i rëndësishëm për shkak të mundësisë të inkluzionit për të gjitha pjesëtarët e grupeve të ndryshme kulturore në kushte të demokracisë në një shoqëri heteogjene etnike. Me fjalë të tjera, përfaqësimi i garantuar në KMNB është një segment veçanërisht i rëndësishëm për akomodim të suksesshëm të dallimeve në një shoqëri të ndarë thellësisht, siç është ajo e Maqedonisë, para së gjithash rëndësia e ruajtjes së tërësisë së sistemit, njëkohësisht duke mundësuar pikërisht kombinim të demokracisë përfaqësuese, participative dhe inkluzive.

Sfidat

Sfida më aktuale lidhur me KMNB-në është ajo e cila del nga kushtet e parapara në kornizën negociuese për asocim të RMV-së në BE. Gjegjësisht, si kusht eksplicit për anëtarësim të vendit i nxitur drejtpërdrejt nga Kriteret e Kopenhagës dhe i shkruar në mënyrë eksplicite në propozim-kornizën negociuese³ është theksuar

3 Më konkretisht në pikën 4 e Draft-Konkluzioneve të Këshillit të BE-së thuhet:

...“It will also enable to strengthen the equal rights of persons belonging to minorities and communities in North Macedonia, and as such, will contribute to the compliance with the Copenhagen political criteria. The Council welcomes in this respect the intention of North Macedonia to launch and achieve as a matter of priority

domosdoshmëria për ndryshimin e Kushtetutës për shkak të njohjes kushtetuese të identitetit të veçantë kulturor të pjesëtarëve të bashkësive joshumicë (siç janë p.sh., bullgarët), e që janë qytetarë të RMV-së. Më konkretisht, gjatë njohjes eventuale të “pakicave kombëtare”⁴ plotësuese në Kushtetutën nevojitet të ndryshohet edhe neni i Kushtetutës i cili e rregullon pikërisht KMNB-në. Bëhet fjalë për nenin 78 të Kushtetutës. Gjegjësisht, pikërisht ky nen pritet të pësojë ndryshime pas ndryshimeve kushtetuese eventuale, e që janë të lidhura me kushtet negociuese për anëtarësim të RMV-së në BE, të përfshirë në Kornizën negociuese. Thjeshtë thënë, pas ndryshimeve eventuale të Kushtetutës në drejtim të rritjes së numrit të anëtarëve të Komitetit, ky institucion është e sigurt se do të rritet si në aspekt të numrit, ashtu edhe në aspekt të vëllimit të punëve të cilat duhet t’i kryejë. Së këndejmi, është e domosdoshme që KMNB-ja të përforcohet në aspektin funksional me shërbimin administrativ personal, që të mund t’i kryejë aktivitetet nga fushëveprimi i tij kompetent.

Madje edhe po të mos ndodhin ndryshimet kushtetuese, e me atë edhe numri i anëtarëve të mos rritet, ky organ edhe më tutje mbetet kryesor për mundësimin e drejtësisë etno-kulturore në pajtim me parimet e demokracisë inkluzive, e veçanërisht përfaqësimin e garantuar dhe ndarjen konsekuente të fuqisë, veçanërisht që kompetenca e tij të vendosë lidhur me kontestin eventual lidhur me çështjen e përdorimit të “parimit të badenterit” në Parlament. Me fjalë të tjera, padyshim se ka rëndësi të veçantë për demokracinë në kontekstin multikulturor, e cila shpesh mund të vijë në kufij të mbijetesës, për shkak se dilemat e sigurisë ndërmjet grupeve në një shoqëri të ndarë thellësisht nuk zhduken përgjithmonë, por përkohësisht. Prandaj edhe përforcimi i tij me shërbimin e veçantë administrativ është më se i nevojshëm.

Kysugjerim për nevojën e përforcimit administrativ dhe operativ të KMNB-së është paraparë në mënyrë eksplicite edhe në propozim-*Strategjinë për ndërkulturalizëm dhe kohezion shoqëror*, ku nevoja për miratimin e saj u shënuar në dokumentin kryesor për asociim në BE, përkatësisht “Skriningun”, si dhe në Raportet e fundit për progresin e RMV-së nga KE-ja; në Raportet e EKRI-t dhe Komitetit Këshillimor i Konventës kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare të Këshillit të Evropës. Ngjashëm si edhe domosdoshmëria për ndryshimet kushtetuese, e cila u shënuar në të gjitha dokumentet e cekura paraprakisht.

Megjithëse, nuk janë vërejtur pengesa substantive specifike në punën e KMNB-së, megjithatë, niveli i polarizimit politik në shoqërinë, është shënuar në raportin e fundit për progresin e RMV-së nga KE-ja, mund ta rrezikojë punën e tij, duke e pasur parasysh kontekstin e kohës, dhe në përgjithësi aktualitetin politik.

the relevant constitutional changes, with a view to including in the Constitution citizens who live within the borders of the state and who are part of other people, such as Bulgarians.”...

⁴ Termi pakicat përdoret këtu veçanërisht për arsye operative, e jo për arsye thelbësore, dhe në asnjë mënyrë nuk synon të sugjerojë çfarëdo statusi inferior ndaj ndonjë grupi më të vogël të identitetit kulturor, anëtarët e të cilit janë qytetarë të RMV-së.

Rekomandime

Grupet kulturore, dhe bashkësitë etnike veçanërisht, shumë shpesh parashtrojnë kërkesa për forma të caktuara të përfaqësimit të garantuar në trupat shtetërore që miratojnë vendime dhe atë jo vetëm në pjesën legislative, e me qëllim të sigurimit të mbrojtjes së interesave dhe të drejtave të tyre, të parandalimit të diskriminimit, të sigurimit të volitshmërive të caktuara dhe të kenë ndikim në punët shtetërore. Nëse ky nuk është rast, ekzistojnë vështirësi me realizimin e të drejtës etno-kulturore, e me vetë atë edhe me efektivitetin e demokracisë. Në mënyrë esenciale, demokracia vihet në pikëpyetje kur cenohet, përkatësisht kur shkelet supozimi i saj për alternim të pakicave (Levine, A., 1990). Edhe krahas asaj që grupet etnike shumë shpesh e gjejnë veten vazhdimisht të përjashtuar nga procesi i miratimit të vendimeve, megjithatë, konsiderohet se çdo grup ndonjëherë duhet të jetë në koalicion fitues.

Meqë në pajtim me përvojën demokratike kjo nuk është e drejtë dhe ka tendencë për të krijuar ose konflikt etnik ose represion (Guinier, L. 1994). Ekzistojnë edhe argumente tjera në favor të **përfaqësimit të garantuar**, por ato nuk janë objekt i këtij punimi⁵. Qëllimi i këtij sugjerimi është i lidhur drejtpërdrejt me Kriteret e Kopenhagës për anëtarësim në BE, të cilat në fakt janë të lidhura me të drejtat e njeriut në kuadër të të cilave përfshihen edhe të drejtat e pakicave ose të drejtat e pjesëtarëve të bashkësive më të vogla. Pikërisht nga kjo perspektivë duhet të interpretohen kushtet e parapara në Kornizën negociuese, e që janë të lidhura me çështjet për njohjen e veçorisë kulturore-identitare të grupeve kulturore në vend.

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, megjithatë, miratoi Konkluzione lidhur me pikat 3 dhe 4 të Konkluzioneve të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe pikën 11 të Qëndrimit të përbashkët të Bashkimit Evropian të miratuar në Mbledhjen politike të Konferencës ndërqeveritare për aderim të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian, të mbajtur më datë 19.7.2022, në pajtim me të cilat ndërmori obligim edhe për **ndryshimet "e theksuara" kushtetuese**. Meqë këto ndryshime kushtetuese e targetojnë përbërjen numerike të KMNB-së, sfidë kryesore për punën e tij përbën pikërisht qasja në ndryshimet kushtetuese. Duke pasur parasysh nivelin shqetësues të polarizimit politik, gjithashtu është shënuar në Raportin e fundit për progresin e Maqedonisë së Veriut nga KE-ja nga data 8

5 Për shembull, Kjukatas pretendon se kjo nuk mund të shihet si jokonsistent me teorinë liberale e cila, që nga Monteskje, e ka njohur rëndësinë e institucioneve të tilla që do të jenë në përputhje me natyrën e rendit shoqëror. Këto mendime të Kjukatas janë argumente lidhur me dizajnin institucional. Më saktësisht, pyetja është: si të dizajnohen institucione të cilat do t'i mbrojnë në mënyrë më efektive të drejtat individuale, dhe të drejtat grupore nuk luajnë rol në justifikimin e mekanizmave të cilat e ruajnë modus vivendi? Ekzistojnë edhe tema të tjera që janë përfshirë në argumentet për përfaqësimin. Për shembull, prezenca e anëtarëve të grupit minoritar, mundësia e anëtarëve të grupit minoritar për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre, si dhe mbrojtja e interesave të grupit minoritar. Këto duhet të argumentohen veçmas, pasi nënkuptojnë lloje të ndryshme aranzhmanesh. (Kukatas, C. 1992)

nëntor 2023, duket se me interes të veçantë është që gjatë këtij aksioni publiku të njoftohet në mënyrë të detajuar me llojin e ndryshimeve lidhur me KMNB-në, ndërsa subjektet politike të jenë në krye të detyrës dhe të mos spekulojnë për pasojat nga ndryshimet kushtetuese që i referohen nenit 78 të KMNB-së. Në atë kuptim, është e domosdoshme që në kuadër të parlamentit, përkatësisht në kuadër të KMNB-së, të hapet sesion informativ lidhur me këtë çështje.

Duke pasur parasysh qëllimin strategjik të RMV-së, e më parë të RM-së për integrim në BE, rekomandimet prioritare kryesore të cilat e tangojnë drejtpërdrejtë punën e KMNB-së, por edhe statusin e demokracisë multikulturore në shtetin tonë, krahas miratimit të ndryshimeve kushtetuese është edhe **miratimi në kohë edhe i Strategjisë për ndërkulturalizëm dhe kohezion shoqëror**, sipas udhëzimeve të së cilës përforcimi administrativ i KMNB-së është shënuar si i domosdoshëm.

Me këtë, konkludojmë se **KMNB-ja** përveç që është përfaqësues esencial dhe faktik për faktin e multikulturalizmit shoqëror maqedonas, ai është edhe organ/trup i cili ka interes të veçantë **për t'u mbështetur nga të gjithë aktorët politikë**, për shkak të natyrës së funksionit të tij. Së këndejmi, përforcimi i tij funksional, operativ dhe administrativ është më se i nevojshëm.

BIBLIOGRAFIA:

Botimet:

- Guinier, L. "The Tyranny of the Majority: Fundamental Fairness in Representative Democracy", New York Free Press/ Macmillan, 1994;
- Kukatas, C. "Are There any Cultural Rights", Political Theory, Vol. 20, No. 1, 1992, Sage Publication Inc. достапно на <http://www.jstor.org/discover/10.2307/191781?uid=3738560&uid=2&uid=4&sid=21103823095211>
- Kymlicka, W. "Liberal Multiculturalism as a Political Theory of State-Minority Relations", Political Theory Vol. 46 (I) 81-91, SAGE Publications.
- Levine, A. "Electoral Power, Group Power and Democracy" во NOMOS XXXI :Majorities and Minorities, уредено од Chapman & Wertheimer, 1990;
- Чупеска, А и Рајчиновска П, И. "Етничките конфликти во меѓународените односи", 2022, FES, Скопје.
- Чупеска, С. А "Мултикултурна акомодација", Везилка, 2017

Dokumentet:

- Draft-Konkluzionet e Këshillit të BE-së ose Propozim-Konkluzionet e Këshillit për BE-në të lidhura për Kornizën negociuese për RMV-në në gjuhën maqedonase janë të disponueshme në https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/draft_council_conclusions_makedonski.pdf, dhe në gjuhën angleze të disponueshme në <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-11440-2022-INIT/en/pdf>
- Kushtetuta e RMV-së është e disponueshme në <http://www.sobranie.mk/ustav-na-rm.nspx>

KOMITETI PËR MARRËDHËNIE NDËRMJET BASHKËSIVE SI AVANGARDË E MARRËVESHJES KORNIZË TË OHRIT

PROF. DR. RIZVAN SULEJMANI, UNIVERSITETI “NËNA TEREZA”, SHKUP

NATYRA E KONFLIKTIT TË VITIT 2001 – PASOJAT

Çfarë ndodhi saktësisht në vitin 2001, ende nuk ka një qëndrim i ndërtuar qartë ndërmjet shkencëtarëve as ndërmjet politikanëve, kështu që ky konflikt trajtohet si konflikt i armatosur, në grupe të caktuara në atë kohë edhe si “akt terrorist”, bile edhe si sulm nga vendi fqinjë, Kosova, e cila në atë kohë ishte nën protektoratin e Kombeve të Bashkuara (KB), ndërsa te elita shkencore dhe politike shqiptare kryesisht trajtohet si luftë ndëretnike.

Megjithëse nuk e kemi definuar qartë, i llojit dhe karakterit të tillë ishte konflikti i vitit 2001 në Republikën e Maqedonisë, teorikisht mund të përfshihet në kuadër të konflikteve që zhvillohen në territorin e ish-Jugosllavisë për të cilat, Domenik Schnaper, thotë: “Konfliktet të cilat sot, për shembull, ndodhin në Ballkan, nuk janë konflikte kombëtare por etnike ose nacionaliste, ato e tregojnë dobësinë e traditës së kombit të pastër të ish-Jugosllavisë, të cilët donin të formojnë komb në vitin 1919, nga bashkësia serbe, kroate, sllovene, boshnjake, hungareze dhe shqiptare” (Schnapper, D.2003:31).

Qëndrimin se konfliktet janë me motive nacionaliste ose etnike, e vërteton edhe Gil White i cili nacionalistin e definon si “Personalitet i cili beson se bashkësia e tij etnike duhet të jetë një bashkësi sovranë politike...” (Gil-White, F. :27). Ndërsa Thomas Eriksen, thotë se nacionalizmi si dhe ideologjitë etnike i potencojnë ngjashmëritë kulturore të mbështetësve, me çka ai përshkruan kufi, kundrejt tjerëve, gjë që bën ato të jenë të huaj (jashtë grupit). Së këndejmi, tipari dallues i nacionalistit është qëndrimi i tij ndaj shtetit. Kur liderët politikë të një lëvizjeje etnike i vendosin këto qëllime, lëvizjet etnike sipas definicionit bëhet nacionaliste (Eriksen, Th.H. 2002:7).

Në hulumtimin nr. 10-2006/2007 të një grupi autorësh, me titull “Ndarja e pushtetit model i ri i vendosjes në komuna multietnike” në komuna multietnike” në hyrjen do të thirren në njohuritë teorike të cilat sipas tyre, “shoqëritë pluraliste janë viktimat potenciale të konflikteve ndëretnike” (Milevska, Hristova, Ananiev, 2007). Për shkak se ato janë shoqëri në të cilat dominojnë ndarje më të vogla dhe më të thella sipas gjatësisë së linjave etnike e kjo pamundëson kohezion më të madh shoqëror, ndërsa potenciali për konflikt rritet. Sipas tyre, në shoqëri të ndara të tilla do të zvogëlohet rreziku nga konflikte etnike, nëse pushteti nuk i anashkalon ose nuk e diskriminon pakicat e tyre (ibid). Për këtë qëndrim të tyre ato thirren në V. Zartman, i cili thotë se, “konfliktet e brendshme janë gjëra shumë të ndryshme, në raste të ndryshme, por të gjitha problemet mund të përmbliken në dy kategori të ndryshme – *anashkalim dhe diskriminim*, ose problem i shpërndarjes dhe problem i identitetit”. Në pamundësi për t’i definuar qartë shkaqet për konfliktin ne si relevante e pranojmë përshkrimin e Zartman “anashkalimi”,

por nëse nuk është diskriminim i drejtpërdrejtë, sigurisht është i tërthortë, duke i pasur parasysh të dhënat për punësim në bazë etnike nga autorët e njëjtë.

Marrëveshja Kornizë e Ohrit – Baza për rregullim të ri të sistemit politik

Marrëveshja kornizë e Ohrit u nënshkrua më 13 gusht 2001 në rezidencën presidenciale të Vodnos në Shkup nga ish-Presidenti i shtetit Boris Trajkovski, ish-kryeministri dhe lider i VMRO-DPMNE-së, Lupço Georgievski, si dhe ish-liderët e LSDM-së, Branko Crvenkovski, PPD-së, Imer Imeri dhe PDSH-së, Arben Xhaferi. Nënshkrime të tyre në marrëveshjen dhanë edhe përfaqësuesit specialë të BE-së dhe SHBA-së, Fransoa Leotar dhe Xhejms Perdjui. Në bisedat që filluan në korrik në Shkup, e pastaj vazhduan në Ohër, u konsultuan më shumë këshilltarë dhe ekspertë.

Marrëveshja përmban edhe tre Aneksë: A. *Amendamente kushtetuese*; B. *Ndryshime në legjislacionin* dhe C. *Implementimi dhe masat për ndërtim të besimit*, si dhe dispozitat përfundimtare⁶.

Në procesin e implementimit të kësaj marrëveshje, i inkorporuar në amendamentet e Kushtetutës, u miratuan mbi 130 ligje, ndryshim-plotësime ligjore, nga të cilat pjesa më e madhe 59 janë ligje për mosdiskriminim dhe përfaqësim të drejtë, 40 janë në sferën e identitetit, kulturës, arsimit dhe decentralizimit të pushtetit⁷.

Duke mos ndërhyrë më tutje në shkaqet dhe pasojat nga konflikti vetëm do të theksojmë se ai përfundoi me marrëveshje paqësore të njohur si Marrëveshje kornizë (të Ohrit), e cila sistemin politik të Republikës së Maqedonisë të dizajnuar sipas Kushtetutës nga viti 1991, e ndryshoi nga sistemi politik monoetnik në sistem politik demokratik i cili do ta përmirësojë dukshëm pozitën e bashkësive që nuk janë shumicë në shtetin. Ky sistem i ri politik përmes amendamenteve kushtetuese e rirregullon shtetin nga një “demokraci shumicë” në një sistem i cili është ndërmjet sistemit të “ndarjes së pushtetit” dhe demokracisë “konsensuale” ose “konsociale” e A. Liphard (Lijphart, A. 1977).

Me këtë shteti i cili sipas përbërjes së tij është i ndarë në mënyrë kombëtare, fetare dhe kulturore, u krijua mundësi institucionale për menaxhim të dallimeve pa përdorim të fuqisë, përmes parimeve demokratike të cilët janë adekuate për shtetet e ndarë ose të fragmentuara.

Karakteristika kryesore e marrëveshjes është se nuk ka zgjidhje territoriale për konfliktet etnike. Në Marrëveshjen e Ohrit qëndron: “Maqedonia është shtet unik ku më tutje me amendamentet tjera kushtetuese identifikohen disa parime themelore dhe institucione në modelin e konsoliduar të demokracisë: 1) përfaqësimi i drejtë i bashkësive

6 Ministria e Sistemit Politik dhe Marrëdhënieve ndërmjet Bashkësive, me rastin e shënimit të 22 vjetorit nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, Shkolla për liderë të rinj „Peace Forum Dialogue” (PFD) me mbi 80 pjesëmarrës. <https://novamakedonija.com.mk/featured/pred-22-godini-se-potpisha-ohridski-ramkoven-dogovor/>

7 Ibid.

në administratën publike, gjyqësi, vetëqeverisje lokale, ushtri dhe polici, në të gjitha institucionet publike; 2) “veto” minoritare/reciproke e cila në Kushtetutën definohet si “shumicë e veçantë” (në gjuhën e popullit quhet shumica e Badenterit); 3) shkalla e lartë e decentralizimit të pushtetit dhe 4) Kushtetuta e shkruar me procedurë të ndërlikuar të amendamentit, e cila nuk lejon ndryshime të lehta kushtetuese, veçanërisht në pjesën e mbrojtjes së të drejtave të pakicave. Këto parime dhe instrumente politike që i parasheh marrëveshja paqësore kanë për qëllim arritjen e stabilitetit dhe sigurisë më të madhe në vend⁸.

Në analizën e mëtutjeshme do të merremi me një institucion, trup i përhershëm punues në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Komiteti për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive (KMNB), i cili është në funksion të implementimit efikas të “shumicës së Badenterit”, si dhe politikave tjera.

Komiteti për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive (KMNB) – baza juridike

Komiteti për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive është trup i përhershëm punues i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut me ç’rast struktura dhe kompetencat e tij dalin nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, më saktësisht amendamenti XII. Sipas të cilit amendament, Komitetin e zgjedh Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, e të cilin e përbëjnë 19 anëtare nga të cilat nga shtatë anëtarë nga radhët e deputetëve të Kuvendit, maqedonas dhe shqiptar, dhe nga një anëtar nga deputetët turq, vllahë, romë, serbë dhe boshnjakë. Nëse ndonjë prej bashkësive nuk ka deputetë atëherë në pajtim me nenin 4 të Ligjit, avokati i popullit pas konsultimeve me përfaqësuesit relevantë të atyre bashkësive, dhe pas mendimit të marrë, Kuvendit do t’i propozojë anëtarë tjerë Komitetit.

Në bazë të amendamentit të përmendur kushtetues në vitin 2002 u miratua Vendim për formimin e Komitetit për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive dhe kryetar i parë u zgjodh Ejup Rustemi. Çështja e funksionimit të komitetit u rregullua më hollësisht në vitin 2007 pas miratimit të Ligjit për Komitetin për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 150 nga 12.12.2007).

Në nenin 1 të këtij Ligji qëndron: “Me këtë Ligj rregullohet themelimi i Komitetit për marrëdhënie ndërmjet bashkësive, mënyra, kushtet, procedura për zgjedhje të anëtarit të Komitetit për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive (në tekstin e mëtutjeshëm: Komiteti), kompetenca, mënyra e punës, miratimi i vendimeve dhe çështje tjera lidhur me punën e Komitetit”.

Që do të thotë se njëra prej detyrave bazë të Komitetit është të shqyrtojë çështje të marrëdhënieve ndërmjet bashkësive dhe të japë mendime për zgjidhjen e tyre. Kuvendi është i detyruar që t’i shqyrtojë mendimet dhe propozimet e Komitetit dhe të vendosë për to.

8 Marrëveshja Kornizë e Ohrit, 13 gusht 2001, e disponueshme në: https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/ramkoven_dogovor-3.pdf

Çështjet për të cilat diskuton dhe miraton vendime Komiteti në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet bashkësive në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë rregulluar në nenin 9 të Ligjit ku si veçanërisht të rëndësishme janë numëruar:

- e monitoron sigurimin e të drejtave të pjesëtarëve të bashkësive të cilat nuk janë shumicë në Republikën të përcaktuara me Kushtetutën dhe ligjin,
- shqyrton çështje parimore nga sfera e marrëdhënieve ndërmjet bashkësive dhe zbatimin e ligjeve, rregullave tjera dhe akteve të përgjithshme me të cilat rregullohen marrëdhëniet ndërmjet bashkësive,
- sugjeron në nevojën për miratimin e ligjeve dhe rregullave tjera dhe akteve të përgjithshme me të cilat rregullohen marrëdhëniet ndërmjet bashkësive,
- realizimi i të drejtës së përdorimit të gjuhës dhe alfabetit të bashkësive joshumicë në Republikën e Maqedonisë, të përcaktuar me Kushtetutën dhe Ligjin,
- realizimi i të drejtës së mësimin në gjuhën e bashkësive joshumicë në Republikën në sferën e arsimit, të përcaktuar me Kushtetutën dhe ligjin,
- realizimi i të drejtës së shprehjes së identitetit dhe veçorive të bashkësive joshumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut në sferën e kulturës, informimit, veprimtarisë botuese dhe në sfera tjera, të përcaktuara me Kushtetutën dhe ligjin dhe
- zbatimi i parimit të përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të qytetarëve që u përkasin të gjithë bashkësive në organet e pushtetit shtetëror dhe në institucionet tjera publike në të gjitha nivelet.

Kompetencat dhe detyrimet e Komitetit dalin nga amendamenti X i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut me të cilin zëvendësohet neni 69 nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, ku rregullohet procedura e votimit, përkatësisht është futur rregulli i quajtur te populli si “Rregulli i Badenterit” për miratimin e ligjeve të cilat i tangojnë drejtpërdrejtë të drejtat e bashkësive kombëtare. Në Ligjin e përmendur është cekur në mënyrë taksative dhe të qartë se për cilat ligje bëhet fjalë, e gjithashtu përcaktohet qartë i a.q. “Rregulli i Badenterit” përkatësisht si bëhet votimi për këto ligje.

Në nenin 11 në pikën 1, 2, 3 dhe 4 janë shënuar ligjet për të cilat Kuvendi vendos me dy të tretën e shumicës, shumicën e votave, me shumicën e të pranishmëve në Kuvendin për të cilin nevojitet shumicë e dyfishtë ose rregulli i badenterit. Për këto çështje nëse paraqitet kontest me bashkësitë si trup i përhershëm punues i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut ka rol të madh, por edhe përgjegjësi në realizimet e të drejtave të përgjithshme dhe të veçanta të bashkësive, përkatësisht të pjesëtarëve të bashkësive. Me këtë Komiteti bëhet institucion kryesor në zhvillimin e komponentit multi-etnik në shoqërinë dhe shtetin pa i anashkaluar të drejtat individuale të njeriut.

Puna e deritanishme të Komitetit për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive

Për rolin dhe kontributin e Komitetit në këtë drejtim në punën e deritanishme do të japim disa të dhëna empirike që bazohen në raportet vjetore për punën e Komitetit të shkarkuara nga faqja e deritanishme e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Pas zgjedhjes së anëtarëve të Komitetit nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, mbledhjen e parë konstituive Komiteti e ka mbajtur më datë 18 shtator 2003, ku kryetar i parë u zgjodh deputeti Ejup Rustemi.

Komiteti për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive 20 vjetorin e mbledhjes konstituive e festoi në mbledhjen e 17-të solemne. Me mbledhjen kryesoi kryetarja e Komitetit, Arbana Pasholli, sipas së cilës është nder dhe kënaqësi të kryesohet me këtë trup, i cili e shënon synimin për ndërtimin e shtetit modern me diversitet multietnik⁹. Në fjalimin e saj Pasholli theksoi se bashkëjetesa ndëretnike mbetet prioritet mbi prioritetet për sigurimin e paqes në vend dhe në rajon, dhe në atë drejtim janë edhe kompetencat e Komitetit për të shqyrtuar çështje lidhur me marrëdhëniet ndërmjet bashkësive të ndryshme. Sipas asaj kohezioni social nuk mund të arrihet pa kultivim të vetëdijes sociale dhe të mësojmë të reagojmë pa paragjykime dhe urrejtje ndaj kulturave të ndryshme me të cilat jetojmë. Pasholli e përfundoi fjalimin e saj me anëtarin e parë të Deklaratës Universale për të drejtat e njeriut: "Të gjithë njerëzit lindin lirshëm dhe të barabartë në dinjitetin dhe të drejtat"¹⁰.

Të ngjashme ishin porositë edhe të folësve, anëtarëve tjerë ose ish-kryetarëve të Komitetit të cilët këtë trup e shohin si vend prej ku mund të dalin ide dhe drejtime për ndërtim të shoqërisë ku, siç theksoi Marija Georgievska duhet, "Të jetojmë për njëri-tjetrin, me njëri-tjetrin, e jo pranë njëri-tjetrin"¹¹.

Çfarë është punuar që të realizohen këto porosi dhe dëshira të shprehura në mbledhjen solemne, do të përpiqemi ta paraqesim përmes numrave të fituara nga raportet vjetore për punën e Komitetit sipas viteve, të shkarkuara nga faqja e internetit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Më poshtë është dhënë lista e kryetarëve sipas viteve që kanë kryesuar me Komitetin.

9 <https://makfax.com.mk/makedonija/%D0%BA%D0%BE%D0%BC%D0%B8%D1%82%D0%B5%D1%82%D0%BE%D1%82-%D0%B7%D0%B0-%D0%BE%D0%B4%D0%BD%D0%BE%D1%81%D0%B8-%D0%BC%D0%B5%D1%93%D1%83-%D0%B7%D0%B0%D0%B5%D0%B4%D0%BD%D0%B8%D1%86%D0%B8%D1%82%D0%B5-%D0%BE/>

10 Ibid.

11 Ibid.

Viti	Kryetari
2002-2006	Ejup Rustemi
2006	Ajdini Naser
2007	Ajdini Naser
2008	Xhevat Ademi
2009	Xhevat Ademi
2010	Rafis Aliti
2011	Xhevat Ademi
2012	Ermira Mehmeti
2013	Ermira Mehmeti
2014	Ejup Rustemi
2015	Ejup Rustemi
2016	Ejup Rustemi
2017	Rexhail Ismaili
2018	Rexhail Ismaili
2019	Rexhail Ismaili
2020	Rexhail Ismaili – Arbana Pasholli
2021	Arbana Pasholli
2022	Arbana Pasholli

Tabela 1. Në tabelën janë dhënë emrat e kryetarëve të Komitetit sipas viteve¹²

Pas analizës së detajuar për atë se çfarë është punuar në këto 20 vitet janë dhënë në Tabelën 2. ku ka të dhëna për numrin e mbledhjeve, pikat e rendit të ditës për të cilat do të diskutohet, sferat por edhe aktivitetet tjera, si dhe shqyrtimin e raporteve, miratimin e vendimeve dhe ngjashëm si dhe aktivitetet, si udhëtime studimore, trajnime, fjalime nga personalitete të njohura dhe autoritete nga sfera e punës së Komitetit.

12 Të dhënat janë marrë nga raportet vjetore për punën e Komitetit, ndërsa janë përpunuar nga autori. Të dhënat për periudhën 2002/2006 janë dhënë në mënyrë kumulative sepse nuk mundëm t'i gjejmë sipas viteve.

Pika të shqyrtuara për sferat		2002-2006 ¹³	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	Totali
Mbledhje të mbajtura		13	2		3	3	8	1	3	5	2	1	1	1	0	0	1	5	6	55
Gjithsej pika të shqyrtuara		17	2		5	3	8	1	3	6	2	2	1	1	0	0	1	5	6	63
Amendamente të parashtruara								0												0
Ligjet sipas sferave	Sistemi politik	5					1													6
	sistemi ekonomik				1															1
	veprimtari publike	3								2										5
Ligje	Leximi 1									2										2
	Leximi 2	3								2										5
	Procedurë e shkurtuar																			
Amendamente të parashtruara		1																		
Buxheti, rebalanci, llogaria përfundimtare																				
Deklaratat, rezolutat																				
Vendime		1									1			1			1			4
Informacion, raporte		4					5	1	3			1								14
ndryshime kushtetuese																				
Iniciativa, strategjike		1								1									1	3
Akte tjera			2		2	3	2				1	1	1						3	15
diskutime mbikëqyrëse										1										1
Pyetje, propozime		1			2													5	2	10
Takime pune, ceremoni, vizita, mysafirë			1			9	9	1	5	8	2	5	1	0	1	0	2	8	22	74

Tabela 2. Në tabelën janë dhënë pika të shqyrtuara sipas sferave dhe viteve në periudhën 2002 deri në vitin 2022¹⁴.


Nga tabela mund të nxirren disa konkluzione: Fillimisht, përfundimisht me vitin 2022 janë mbajtur 55 mbledhje në të cilat janë shqyrtuar 63 pika në rend dite. Së dyti, numri

13 Të dhënat për periudhën 2002-2006 janë dhënë në mënyrë kumulative sepse nuk i kishim në dispozicion sipas viteve.

14 Të dhënat janë marrë nga Raportet për punën e Kuvendit në pjesën e trupave të përhershme punuese ku jepen të dhëna edhe për Komitetin. Përpunimi i të dhënave është bërë nga autori, por kishte vështirësi sepse formati i raporteve me vite derisa e ka marrë formën përfundimtare

më i madh i mbledhjeve janë mbajtur në periudhën 2002 deri në vitin 2006, gjithsej 13 mbledhje në të cilat janë shqyrtuar 17 pika, siç qëndron në raportin nga ajo periudhë kanë pasur disa vazhdimë. Kjo është e kuptueshme nëse kihet parasysh se në atë periudhë kohore janë miratuar pjesa më e madhe e ligjeve që i tangojnë marrëdhëniet ndëretnike, si dhe se bëhet fjalë për periudhën e pas konfliktit, që do të thotë shkallë e ulët e besimit ndërmjet bashkësive, në veçanti ndërmjet dy bashkësive më të mëdha, maqedonase dhe shqiptare. Së treti, në punën e Komitetit ka dominuar shqyrtimi i akteve me gjithsej 15 raporte të natyrës së ndryshme me gjithsej 14. Në vendin e tretë janë shqyrtimi i ligjeve, nga sistemi politik 6, nga veprimtaritë publike 5 të cilët janë shqyrtuar në lexim të parë dhe të dytë.

Një karakteristikë tjetër e punës së Komitetit është ajo që ai nuk ka rrjedhë të barabartë standarde të punës sipas viteve, këtu vërehen tatëpjeta dhe përpjeta në Grafikon 1, është dhënë numri total i mbledhjeve të mbajtura dhe numri total i pikave të shqyrtuara sipas viteve në këtë trup.



Grafiku 1. Pasqyra grafike e numrit të mbledhjeve të mbajtura dhe numri total i pikave të shqyrtuara sipas viteve në periudhën 2002-2022¹⁵.


Për një pjesë të këtyre tatëpjetave, ose aktiviteti i zvogëluar mund të gjendet sqarimi siç është periudha e krizës me pandeminë. Por, për periudhën 2006-2008 dhe 2011 kur ka gjithashtu zvogëlim të madh të vëllimit të punës në këtë trup gjendet vështirë sqarim në faktorët e jashtëm përveç faktorit njeri lidhur me kryesimin e Komitetit ose mungesë të vullnetit politik, të vihen në rend dite për shqyrtim të çështjeve që i tangojnë marrëdhëniet ndëretnike.

Meqë caktohet vështirë korrelacioni ndërmjet ngjarjeve politike në shtet dhe në punën e Komitetit, që të kemi njëfarë sqarimi për dallimet e mëdha në aktivitetet e këtij trupi

¹⁵ Në këtë grafik periudha 2002-2006 numri i mbledhjeve të mbajtura dhe gjithsej pikat e shqyrtuara janë paraqitur në mënyrë kumulative.

shumë të rëndësishëm, bëmë analizë të lidhshmërisë së aktiviteteve me kryetarët e Komitetit sipas viteve.

Në Grafikon 2. Është dhënë numri total i mbledhjeve të mbajtura të Komitetit, por edhe aktiviteteve tjera shtesë të cilat nuk janë të lidhura me mbledhjet ose pikat e rendit të ditës, trajnime, vizita studimore, takime me personalitete të rëndësishme nga sfera të cilat janë objekt i interesimit të Komitetit, pavarësisht nëse realizohen në përbërje të plotë të Komitetit ose nga kryetari, të cilët janë shënuar si aktivitete shtesë.




Grafiku 2. Numri i mbledhjeve dhe aktiviteteve shtesë

Analizat e të dhënave tregojnë se ka dallim të madh sipas viteve, por dallimi më i madh vërehet kur kërkohet korrelacion i aktiviteteve shtesë me kryetarin i cili në atë periudhë kohore e udhëheq Komisionin. Nëse numri i mbledhjeve mund të lidhet me aktivitetet politike të Qeverisë dhe Kuvendit, por edhe nga ngjarjet politike, aktivitetet shtesë janë të lidhura ngushtë me vetëiniciativën, dëshirën për dukshmëri dhe proaktivitet të kryetarit të Komitetit.

Është e dukshme se në kohën kur me Komitetin udhëheq Arbana Palloshi 2021-2022, ka një gamë të gjerë të aktiviteteve, që gjithashtu mund të vërehet edhe në periudhën kur kryetarë të Komitetit ka qenë Ermira Memeti dhe Rafiz Aliti.

Nëse shkojmë edhe një hap më tutje, të bëhet një raport i aktiviteteve të Komitetit të shprehura sipas numrit total të mbledhjeve të mbajtura dhe numrit total të aktiviteteve mesatarisht në vit përderisa kanë qenë kryetarë, vërtetohen dy korrelacione. I pari është se tipari dominues është aktiviteti sipas viteve, në grafikun e paraqitur përmes lakores me të kaltër të çelur, është i lidhur drejtpërdrejt me atë se kush kryeson me Komitetin. Tipari i dytë, megjithëse jo me besueshmëri të madhe, për shkak të mostrës ende të vogël, është se gratë si kryetarë të Komitetit janë shumë më aktivë, që shihet nga aktivitetet e Arbana Palloshit dhe Ermira Memetit. Rafiz Aliti ka sukses të mirë, por për shkak të

periudhës së shkurtër kohore në funksionin e kryetarit, vetëm një vit, nuk mund të merret si shembull, kundrejt kryetarëve tjerë, të gjinisë mashkullore, të cilët janë shumë më pak tivë si kryetarë të këtij trupi.



Grafiku 3. Pasqyra grafike e viteve të kryesimit, numri total i mbledhjeve të mbajtura dhe numri total i aktiviteteve si dhe mesatarja sipas viteve të numrit të mbledhjeve të mbajtura dhe numrit të aktiviteteve.

Rezultatet tregojnë për rolin e madh që mund ta ketë një qasje proaktive, kundrejt asaj pasive, pritjes dhe trajtimit rutinor të detyrimeve ligjore në njohjen dhe rritjen e rolit të Komitetit. Që do të thotë se personaliteti i cili udhëheq me këtë trup, ka ndikim të dukshëm mbi aktivitetet e përgjithshme të Komitetit.

Rezime përfundimtare

Komiteti për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive është prodhim i një konteksti historik i cili është i lidhur me konfliktin në vitin 2001, por sot është një prej instrumenteve kryesore për menaxhim institucional të marrëdhënieve ndëretnike në një procedurë parlamentare demokratike.

Nga analiza e legjislacionit aktual i cili e rregullon punën e KMNB-së, Ligji për Komitetin për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive, mund të konstatohet se nuk e përpunon në tërësi dispozitën kushtetuese e cila del nga Amendamenti XII, në veçanti alineja 2 e pikës 1.

Analiza e raporteve për punën e KMNB-së në periudhën 2002-2022, na jep të drejtë të konstatojmë se përfaqësuesit popullorë e njohin rolin kryesor të këtij trupi për ndërtim

të demokracisë multietnike në një shoqëri të fragmentuar përmes debatit parlamentar.

Numri i mbledhjeve të mbajtura dhe pikave që janë shqyrtuar tregojnë se Komiteti nuk ka arritur të imponohet si trup i përhershëm i veçantë i cili është rregulluar me Ligj, që i jep një peshë specifike të cilën nuk e kanë komisionet dhe trupat tjerë të përhershëm të Kuvendit.

Analiza e detajuar gjithashtu tregon se puna e këtij trupi varet drejtpërdrejtë nga rrethanat dhe kontekstet politike, e veçanërisht nga pozita e kryetarit të Komitetit.

Analiza tregon se proaktiviteti i kryetarit/kryetares kontribuon dukshëm për afirmimin dhe njohjen e tyre.

Rekomandimet

Konteksti nga i cili lind ideja për KMNB-në, konflikti ushtarak nga viti 2001 dhe Marrëveshja kornizë e Ohrit, nuk duhet të jenë barrë që **në mënyrë objektive dhe reale të vlerësohet roli i këtij trupi të përhershëm**, për funksionimin e demokracisë parlamentare në një shtet multietnik, kundrejt disa pengesave për legjislacion efikas. KMNB-ja, duhet të **njihet dhe pranohet dukshëm si një mekanizëm institucional kryesor** për tejkalimin e keqkuptimeve ndërmjet bashkësive përmes rrugës institucionale dhe demokratike, përmes procedurës parlamentare.

Për ta luajtur rolin e institucionit për menaxhim me dallimet etnike, kulturore, fetare doemos duhet të intervenohet në Ligjin për Komitetin për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive, edhe përmes interpretimit të zgjeruar të Amendamentit XII, në veçanti alineja 2 pika 1, të përforcohet pozicioni i Komitetit në Kuvend si trup i veçantë i cili **do të jetë në punime të përhershme për t'i monitoruar marrëdhëniet ndëretnike** në shtet. Intervenimet në Ligjin duhet të sigurojnë **kritere, standarde dhe kornizë kohore për dinamikën e punës së** KMNB-së, me çka aktiviteti nuk do të varet nga personaliteti që e kryen funksionin e kryetarit.

Anëtarët e Komitetit, në veçanti kryetari/kryetarja duhet të punojnë në dukshmërinë e këtij trupi, përmes punës transparente **ta rrisin besimin te qytetarët** për punën e tyre në funksion të përforcimit të marrëdhënieve ndëretnike. Komiteti duhet të punojë të vihet në **rolin e zbulimit të hershëm dhe parandalimit të** marrëdhënieve të **cenuara ndëretnike** në vend të zgjidhjes, e së paku në rolin vetëm të shuarjes së pikave të nxehta.

Në funksion të rritjes së rolit të tyre Komiteti doemos duhet të ketë mbështetje të tij **të veçantë administrative profesionale** në të cilin sipas nevojës do të **përfshihen ekspertë dhe punëtorë shkencorë**.

BIBLIOGRAFIA

- Eriksen, Thomas Hylland, 2002 *Ethnicity and Nationalism*, 2nd Edn., Pluto Press, EU,
- Gil-White, Francisco J. The study of ethnicity needs better categories Clearing up the confusions that result from blurring analytic and lay concepts,
- disponueshëm në: <https://tamilnation.org/selfdetermination/nation/gilwhite.pdf>
- Lijphart, Arent. 1977, "Democracy in Plural Societies", Yale University Press
- Милевска Мирјана, Христова Лидија, Ананиев Јован. 2007, „Споделување на власта нов модел на одлучување во мултиетнички општини“, Истражување Бр10-2006/2007, disponueshëm: <https://www.academia.edu/80934018/%D0%A1%D0%BF%D0%BE%D0%B4%D0%B5%D0%BB%D1%83%D0%>
- Schnapper, Dominique. 2003, "La communauté des nation, Sur L'idée moderne des citiyeu", превод на македонски: „Заедница на граѓани – кон модерна идеја за нацијата“, Слово, Скопје.

PROF. DR. RUBIN ZEMON, QENDRA PËR KËRKIME TË AVANCUARA, SHKUP, SHKUP

VËSHTRIM I SHKURTËR MBI TEORITË DHE POLITIKAT MULTIKULTURORE

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, multikulturalizmi liberal është pjesë e jetës së përditshme në kuadër të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit (MKO), që u nënshkrua si epilog i konflikteve ushtarake dhe u inkorporua në amendamentet kushtetuese, ndërsa demokracia konsociale i përket fushës së institucioneve politiko-legjislative (Zemon R. 2018:190). **Me fjalë të tjera, multikulturalizmi liberal është joformal dhe i nënshtruar ndaj rregullave të përditshmërisë, ndërsa demokracia konsociale është formale, multikulturalizëm institucional.** (Stanković Pejnović V., 2016:363).

Termi multikulturalizëm paraqitet në literaturën me tre emërtime krejtësisht të ndryshme: i pari, si përshkrim faktik i gjendjes/realitetit që ndonjëherë përshkruhet si “pluralizëm kulturor”; i dyti, si recetë normative për organizimin e shoqërisë – që ndonjëherë përshkruhet si “politika e dallimeve”, “identitet në politikën” ose “politika e njohjes”; dhe i treti, si term kryesor për politikën e ndryshme qeveritare, përfshirë edhe çështjen e përdorimit të gjuhës së integritetit në shoqërinë, mbështetjen e manifestimeve kulturore dhe qendrave të bashkësive, etj. (Tejllor Ç.2004: 25-69; Kimlicka W. 1995).

Multikulturalizmi në kuptimin e tij përshkruar është pranuar përgjithësisht. Shoqëritë gjithmonë përmbajnë njerëz të bindjeve të ndryshme fetare, përkatësisë etnike, mënyra të ndryshme të jetesës dhe koncepte të të kuptuarit të jetës. Por, pranimi i diversitetit të shoqërisë, nuk do të thotë se shtetet janë të përkushtuar detyrimisht ndaj kërkesave normative të multikulturalizmit, që fokusohet në respektimin e dallimeve kulturore në vend të stigmatizimit, përfshirjes në vend të përjashtimit nga jeta publike. Multikulturalistët pretendojnë se politika shtetërore ndikon në mënyrë të ndryshme ndaj anëtarëve të grupeve të ndryshme kulturore, e me atë duhet të rishqyrtohet edhe filozofia politike (Kimlicka, W.1999).

Duke u mbështetur në qëndrimet e Kimlickës, në bashkëautorësi me Magda Opalski, Tomislav Zhimjanov e caktoi multikulturalizmin si: “tërësi e përpjekjeve të autoriteteve shtetërore ose politike në planin e njohjes së identiteteve të grupeve etnonacionale në sferat e publikut, si dhe për aktivitetet e ndryshme për përshtatje të dallimeve kulturore ekzistuese në shoqërinë e caktuar”. (Todorović, D. 2007: 42).

Në diskursin për demokracinë liberale dhe multikulturalizmin, në hapësirën publike u përplasën dy politika: “politika e të drejtave të barabarta civile” dhe “politika e dallimeve”. Ndërsa politika e dinjitetit insiston të promovojë mosdiskriminim të mënyrës e cila është “e verbër për dallimet”, politika e dallimeve e ridefinon mosdiskriminimin dhe kërkon trajtim të diferencuar në bazë të veçorive individuale dhe kulturore. Në përplasjen e

tillë ndërmjet dy politikave kur njëra palë insiston ta ruajë veçorinë kulturore, ndërsa tjetra të promovojë interesa të individit, neutraliteti është i pamundshëm. (Tejllor, Ç. 2004: 30)

Sipas analistit politik francez Andrea Semprini, multikulturalizmi ngre tre çështje esenciale: 1) çështja për diversitetet, 2) çështja për të drejtat a pakicave lidhur me shumicën, dhe 3) çështja për identitetin dhe njohjen e tij. Ai kryen klasifikim të qasjeve të shumta në multikulturalizmin në vendet e zhvilluara moderne, me ç'rast kriteret për ndarje janë veçanërisht të ndërlikuara sepse në to janë të integruara, përveç tre çështjeve të përmendura esenciale, edhe sfera publike dhe private. (Todoroviq, D. 2007: 42)

Modeli liberal multikulturor i Vill Kimlicka shënon ndarje institucionale të bashkësive kulturore në kuadër të një bashkësie politike, për shkak të ruajtjes dhe mbrojtjes së identitetit të tyre të veçantë, me çka ai deri tani i përballon më së miri testet e përditshmërisë. Kimlicka e ofron konceptin liberal-demokratik të drejtësisë etnokulturore duke e kritikuar modelin liberal politik klasik dhe neutralitetin, para së gjithash në politikën e SHBA-së, gjatë përballjes me heterogjinitetin etnokulturor. Kimlicka zotohet për mbrojtje të kulturave të bashkësive, e jo për mbrojtjen e bashkësive. Modeli liberal-demokratik i drejtësisë etnokulturore përfshin hapësirë të veçantë për pakicat në kushte të një ndarjeje më të barabartë të hapësirës publike në shoqërinë, dhe është bazuar në integrimin e pakicave në një kulturë mjaft të gjerë shoqërore. Kultura shoqërore, si një kulturë e përqendruar territorialisht e bazuar në një gjuhë të përbashkët që përdoret në një gamë të gjerë institucionesh shoqërore, "u ofron anëtarëve të grupit mënyra të ndryshme jetese në kuadër të aktiviteteve të pasura dhe të ndryshme, përfshirë jetën sociale, arsimore, fetare, rekreative dhe ekonomike, me ç'rast përfshihet sfera publike dhe private." (Kimlicka V. 2004: 89).

Numri i madh i teoricienëve janë dakord se parakusht themelor për ndërtimin e multikulturalizmit është **toleranca**. Toleranca është supozim themelor i shoqërisë civile. Ndërkaq, toleranca nuk duhet të kuptohet si inferioritet dhe mosinteresim ndaj tjetrit, i cili doemos duhet të tolerohet, por si vetëzotërim dhe kujdes ndaj tjetrit. Sjellja tolerante ndaj "tjetrit" dhe "palës së ndryshme" do të thotë edhe DIALOG me "ato që janë pranë nesh". Dialogu i referohet shkëmbimit të kulturave, të pranimit-dhënies së ndërsjellë, gjë që është nivel shumë më i lartë i tolerancës. Në Maqedoni dhe në Ballkan, ka numër të madh të shembujve të dialogut solid dhe tolerancës së pjesëtarëve të kulturave të ndryshme. Parimi i respektit të ndërsjellë, është element esencial i bashkëjetesës në këto hapësira. Komunikimi i drejtpërdrejtë ballë për ballë, me ç'rast është ndërtuar raporti i besimit dhe fqinjësisë së mirë në nivel individual dhe sipas karakteristikave personale, e jo për shkak të të drejtave të bashkësisë sipas sistemit juridik. (Janev, G 2005: 97-110).

Megjithatë, në kushte të demokracisë liberale dhe ekonomisë së tregut, marrëdhëniet varen në masën më të madhe nga sistemi juridik dhe politik. Të kuptuarit normativ të multikulturalizmit duhet të krijojë supozime për kultivimin e dialogut në institucionet e sistemit, në hapësirën publike, përkatësisht mediat, e para së gjithash në sistemin arsimor.

Komiteti për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive në kornizën ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të pakicave

Mbrojtja e pakicave kombëtare është një prej çështjeve më të vjetra të cilave u referohet e drejta ndërkombëtare, ndërsa e drejta e pjesëmarrjes, e cila siguron angazhim politik efektiv në nivel kolektiv, është kategori e paradokohshme relative juridike dhe politike, ndonjëherë e karakterizuar si e drejtë e “gjeneratës së tretë” e të drejtave të pakicave.

Në parim, e drejta e pjesëmarrjes në çështjet publike-ndërkombëtare u vendos në vitin 1990, me theks në pjesëmarrjen politike efektive, përkatësisht angazhimin i cili ka ndikim mbi rezultatet nga proceset e vendimmarrjes. Termi përfshin jo vetëm përfaqësim në trupat legjislativ, por edhe përfshirje në çështjet publike. Baza parësore e mekanizmave për pjesëmarrje politike është vendosja e shoqërisë e cila siguron barazi esenciale, ose barazi në realitetin, kundrejt barazisë në të drejtën që është e ngjashme me aspektin e shumicës në shoqëri. Në esencë e drejta e pjesëmarrjes efektive është e inkorporuar në Deklaratën e KB-së për të drejtat e personave që u përkasin pakicave nacionale ose etnike, fetare dhe gjuhësore [neni 2(2) dhe 3], Dokumenti i KSBE-së nga Kopenhaga (paragrafi 35), si dhe garancitë e Konventës kornizë për mbrojtje të pakicave kombëtare (KKMPK) (neni 15), duhet të sigurojnë se pakicat kanë qasje të barabartë në vendimet politike në të gjitha format dhe në të gjitha nivelet e pushtetit. Pra, e drejta e pakicave në pjesëmarrjen politike ka për qëllim mbrojtjen, afirmimin dhe promovimin e identitetit të pakicave.

Kur bëhet fjalë për mbrojtjen ndërkombëtare dhe implementimin e të drejtave të njeriut, sistemi universal i mbrojtjes dhe zbatimi i të drejtave të njeriut e definon pjesëmarrjen politike në nivel individual në nenin 25.3 të *Paktit ndërkombëtar për të drejtat qytetare dhe politike* (PNDQP).

Çdo qytetar do të ketë të drejtë dhe mundësi, pa asnjërin prej dallimeve të përmendura në nenin 2 dhe pa kufizime joracionale: (a) të marrë pjesë në udhëheqjen e punëve publike, drejtpërdrejt ose përmes përfaqësuesve të zgjedhur lirisht; (b) Të votojnë dhe të zgjidhen në zgjedhje të vërteta periodike të cilat do të jenë me votim të përgjithshëm dhe të barabartë dhe do të mbahen me votim të fshehtë, garantimi i shprehjes së lirë të vullnetit të votuesve; (c) Të ketë qasje, nën kushte të përgjithshme të barazisë, në shërbimin publik në vendin e tij”¹⁶.

Me rëndësi të veçantë për këtë tematikë është dokumenti i OSBE-së, i miratuar në vitin 1999 i titulluar *“Rekomandimet nga Llund për pjesëmarrje efektive të pakicave kombëtare në jetën publike”*¹⁷. Në bazë të përvojës së Komisarit të lartë për pakicat kombëtare të OSBE-së dhe këshillave të ekspertëve të njohur ndërkombëtarisht, këto rekomandime përpiqen të sigurojnë udhëzime për vendet-anëtare të OSBE-së për atë se si të sigurohet më së miri pjesëmarrja e pakicave kombëtare në shtetet e tyre. Rekomandimet përfshijnë parime të përgjithshme; pjesëmarrje në vendimmarrje, përfshirë arranzhmane në nivel qendror, rajonal dhe lokal, zgjedhje dhe trupa këshillimore dhe konsultative; vetëqeverisje, që

16 International Covenant on Civil and Political Rights, adopted on 16 December 1966, entered in force on 23 March 1976, Treaty Series, 999, 171.

17 <https://www.osce.org/hcnm/lund-recommendations>

përfshin arranzhmane territoriale dhe joterritoriale; dhe garanci, përfshirë edhe masa mbrojtëse kushtetuese dhe juridike dhe mjete juridike.

Konventa kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare (KKMPK) e Këshillit të Evropës është dokumenti kryesor për shqyrtim në kontekst të sistemit të të drejtave të njeriut sepse ai është instrumenti i vetëm obligativ ligjor i cili i rregullon të drejtat e pakicave¹⁸. Në pajtim me Sqarimin e KKMPK-së, Konventa, si instrument “i butë” i të drejtës së ngurtë, në pjesën më të madhe përbëhet nga dispozita që i përcaktojnë qëllimet të cilat palët (shtetet) janë të obliguar t’i realizojnë. Duke u lejuar që për të dytë, si për margjinat për implementim dhe ashtu edhe për diversitetin në qasjen e shteteve, Komiteti Këshillimor i KKMPK-së të tregojë ndjeshmëri ndaj nevojave të ndryshme të shteteve anëtare që i kanë për shkak të probabilitetit të madh se masa e caktuar e cila shpie në pjesëmarrjen efektive në një shtet, nuk do t’i sigurojë rezultatet e njëjta në tjetër. Më saktësisht, neni 15 i këtij instrumenti e rregullon pjesëmarrjen efektive, e cila vijon: “Palët do të sigurojnë kushte të domosdoshme për pjesëmarrje efektive të personave që u përkasin pakicave kombëtare në jetën kulturore, shoqërore dhe ekonomike dhe në çështjet publike, veçanërisht ato që i tangojnë”.

Megjithatë, edhe ekspertët edhe Komiteti Këshillëdhënës pretendojnë se neni 15 mund dhe duhet të interpretohet si bazë juridike për të drejtën e pakicave të pjesëmarrjes politike në proceset e vendimmarrjes, jo vetëm për çështjet të cilat i tangojnë drejtpërdrejt, por edhe për çështjet e domenit më të gjerë që i tangojnë, që rezultojnë me përfshirje të pakicave në proceset e vendimmarrjes për të gjitha çështjet. Si pjesë e të drejtës së grupeve të pakicës në pjesëmarrjen politike, përfshin pjesëmarrje në trupat e zgjedhura, shërbimet publike dhe gjyqësinë, subjektet e specializuara qeveritare, pushtetin e decentralizuar dhe lokal, mekanizmat për konsultime dhe aranzhime kulturore për autonominë. Komenti i njëjtë i përfshin komponentët socialë dhe kulturorë të pjesëmarrjes së pakicave, me qëllim të sigurimit të qasjes në projektet zhvillimore, punësimin, resurset, shpërndarjen, shëndetin dhe mbrojtjen sociale, qasjen në arsimin, mediat dhe mbrojtjen e përgjithshme të identitetit¹⁹.

Republika e Maqedonisë së Veriut është ndër vendet e para anëtare të Këshillit të Evropës që re pranoi KKMPK-në. E njëjta u nënshkrua më datë 25 korrik 1996, ndërsa u ratifikua në Kuvend më datë 10 prill 1997. Konventa kornizë hyri në fuqi, si pjesë e legjislacionit të Maqedonisë më datë 1 shkurt 1998. Për zbatimin e dispozitave të KKMPK-së deri tani për Republikën e Maqedonisë së Veriut kanë përfunduar 5 cikle monitorimi, dhe në vijim është cikli i 6-të. Megjithatë, për punën e Komitetit për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive mund të gjejmë shënim vetëm në mendimet e Komitetit Këshillëdhënës të KKMPK-së në ciklin e parë dhe të dytë të monitorimit.

Në ciklin e parë të monitorimit, Mendimi është publikuar në vitin 2004, thuhet se Komiteti Këshillëdhënës e përshëndet ekzistimin e një sërë dispozitash kushtetuese që ndihmojnë të pasqyrohen interesat e personave që u përkasin pakicave në procesin

18 Framework Convention for the Protection of National Minorities, adopted on 1 February 1995, entered in force on 1 February 1998, ETS No. 157. <https://rm.coe.int/168007cdac>

19 ACFC, Commentary on the Effective Participation of Persons Belonging to National Minorities in Cultural, Social and Economic Life and in Public Affairs, adopted on 27 February 2008, ACFC/31DOC(2008)001. <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016800bc7e8>

këshillëdhënës. Komiteti këshillëdhënës shënon, për shembull, se Kushtetuta ka futur sistem të shumicës së dyfishtë për miratimin e ligjeve që i tangojnë pakicat (kultura, përdorimi i gjuhëve, arsimi, dokumentacioni personal dhe përdorimi i simboleve). Sipas këtij arranzhmani, ligjet e tilla doemos duhet të sigurojnë jo vetëm shumicë votash, por edhe shumicë të votave të përfaqësuesve që pretendojnë se u përkasin bashkësive që nuk janë shumicë në popullatën. Kjo procedurë e veçantë aplikohet edhe gjatë emërimit të Avokatit të Popullit. Komiteti Këshillëdhënës e shënon edhe "formimin e komitetit parlamentar special, Komitetit për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive, në të cilin pjesëmarrja e pakicave është e garantuar."²⁰

Mendimi i dytë i Komitetit Këshillëdhënës të KKMPK-së u publikua në vitin 2007, ku thuhet se *"edhe krahas asaj që e përshëndet progresin e shënuar lidhur me pjesëmarrjen e pakicave, Komiteti Këshillëdhënës shënon se, sipas përfaqësuesve të këtyre të fundit, kjo pjesëmarrje nuk e ka gjithmonë ndikimin e pritur. Kështu, në Kuvend, anëtarët e Komitetit për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive Etnike konsiderojnë se qëndrimet e tyre nuk merren parasysh mjaftueshëm, sidomos gjatë përgatitjes ose ndryshimit të legjislacionit në fusha të ndryshme që i tangojnë pakicat kombëtare. Ata këtu i cekin diskutimet e fundit për ligjet që kanë të bëjnë me policinë dhe Rregulloren e punës së Kuvendit (veçanërisht aspektin gjuhësor), në të cilat ishte veçanërisht e vështirë për ta që të dëgjohej zëri i tyre."*²¹

Nga ana tjetër, Komisioni Evropian ka konstatuar disa herë se *"institucionet përkatëse janë të dobëta në zbatimin e politikave që kanë të bëjnë me pakicat"*. Në shtëpinë legjislative, përkatësisht në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut ekziston **Komiteti për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive, i themeluar në bazë të Kushtetutës. Më saktësisht, me amendamentin XII të Kushtetutës, neni 78, Kuvendi është i detyruar që t'i shqyrtojë mendimet dhe propozimet e Komitetit dhe të sjellë vendim lidhur me to. Megjithatë, që nga themelimi i Komitetit e deri më tani, ky organ nuk ka arritur të imponohet si një nga organet e rëndësishme në sistemin politik të Republikës së Maqedonisë së Veriut për integrimin e plotë të shoqërisë multikulturore dhe multietnike, sepse është jofunksional. Në disa raporte të KE-së në vitet e kaluara është kritikuar ashpër për mosfunksionim dhe pamundësi për t'iu përgjigjur kompetencave kushtetuese dhe ligjore. Gjithashtu, është evidente edhe përjashtimi dhe kundërshtia e praktikës me amendamentin VI të Kushtetutës që garanton përfaqësim adekuat dhe të drejtë të të gjitha bashkësive në organet dhe institucionet shtetërore. Me numrin e përcaktuar saktësisht të anëtarëve në Komitet, pjesëtarëve të bashkësive "tjera" që jetojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk u jepet mundësia e plotë të kenë përfaqësuesin e tyre që do t'i përfaqësojë interesat e 10% të popullatës jomaqedonase dhe joshqiptare, edhe krahas asaj që në mandatin e që i është dhënë Komitetit shqyrtohen çështjet të cilat i tangojnë drejtpërdrejt interesat e qytetarëve - pjesëtarëve të bashkësive. (Zemon, R. 2021:9).**

Gjithashtu, në Pasqyrën e Marrëveshjes së Ohrit për kohezion social" nga viti 2015, rekomandohet" *...të vihet theks i veçantë në ekzistimin e Komitetit për Marrëdhënie ndërmjet*

20 <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=090000168008bd41>, faqe 22

21 <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=090000168008c189>, faqe 35

*Bashkësive në Kuvendin e RM-së në funksion të zhvillimit të marrëdhënieve ndëretnike konstruktive, si dhe nxitjen e debateve të vazhdueshme dhe konsensusit për marrëdhënie ndëretnike dhe integrim të shoqërisë, jo vetëm gjatë ndërhyrjeve urgjente në situatat tensionuese. ...të kihet parasysh zgjerimi i përbërjes së komisionit të Kuvendit për marrëdhënie ndërmjet bashkësive, me qëllim të sigurimit të hapësirës edhe për numrin e bashkësive më të vogla (kategoria "tjerë", në preambulën e Kushtetutës)."*²²

Trupa të ngjashme në vendet e rajonit

Instituti Parlamentar në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në shkurt të vitit 2021, ka përgatitur një analizë krahasuese në 9 vende të rajonit me organet e tyre parlamentare që kanë kompetencë në raport me komunitetet dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre. Nga nëntë vendet e analizuara, në shtatë prej tyre (Republika e Maqedonisë së Veriut, Republika e Serbisë, Republika e Kroacisë, Republika e Malit të Zi, Republika e Sllovenisë, Republika e Kosovës, Republika e Bullgarisë), parlamentet kombëtare kanë komisione që merren me çështjet e bashkësive apo pakicave kombëtare dhe të drejtat e tyre, statusin dhe zhvillimin në zonat, ndërsa në dy prej tyre, si Bosnja dhe Hercegovina dhe Shqipëria, nuk parashikohen trupa të tillë punuese.

Krahas me Rregulloren e Punës së Kuvendit të Kosovës, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Bashkësive dhe Kthim parashihet edhe me Kushtetutën e Kosovës. Në 5 vendet e tjera, komisionet rregullohen me Rregullore të punës të parlamenteve kombëtare. Në të gjitha shtetet, këto komisione janë paraparë si trupa të përhershëm punuese, me emra të ndryshëm në shtete të ndryshme dhe me të ngjashme, por në disa prej tyre, dhe me kompetenca të zgjeruara lidhur me zona tjera, jashtë zonës së bashkësive apo pakicave kombëtare.

Struktura organizative në të 7 vendet është pothuajse identike, me karakteristikë në Kroaci dhe Serbi, ku komisionet mund të formojnë edhe nënkomisione, përgjegjësitë e të cilëve ndahen sipas punës dhe kompetencës së nënkomisioneve. Gjithashtu, Komisioni punon sipas Rregullores së vet të punës. Përveç realizimit të të drejtave të pakicave kombëtare, ka kompetencë edhe për realizimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Kompetencat e Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore të Republikës së Serbisë janë në fushën e lirisë së besimit dhe pozitës së bashkësive fetare, por edhe në fushën e realizimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe lirive dhe të drejtave të fëmijës.

Kompetencat e Komisionit për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut të Malit të Zi u referohen edhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të qytetarëve, si dhe zbatimit të akteve të ratifikuara ndërkombëtare lidhur me ato të drejta. Njëkohësisht promovon aktivitete në lidhje me çështjet kombëtare dhe etnike, si dhe zbatimin e masave, veçanërisht për çështjet në fushën e arsimit, shëndetësisë, punësimit, politikës sociale etj.

²² „Pasqyra e Marrëveshjes së Ohrit për kohezion social”, Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Sekretariati për zbatimin e MKO-së, Shkup 2015, faqe 11

Kompetencat e Komisionit për Bashkësi Kombëtare të Sllovenisë rregullojnë çështjet dhe statusin e bashkësive, si dhe zhvillimin e tyre në aspektin e arsimit, kulturës dhe aktiviteteve ekonomike. Vendimet për këto çështje merren në pajtim me deputetët e bashkësive kombëtare.

Kompetencat e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Bashkësive dhe Kthim të Kosovës kanë të bëjnë me avancimin për zgjidhje të duhur dhe të drejtë të të drejtave dhe interesave të bashkësive. Komisioni jep rekomandime për draft-ligje, si dhe propozime në Komisionin për Buxhet dhe Transferime. Fushat e përbashkëta të këtyre trupave punuese në parlament janë kultura, arsimi dhe aktet që rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet pjesëtarëve të bashkësive, të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj. Në tetë nga shtetet e analizuara, ekzistojnë institucione ose organe të veçanta që i rregullojnë çështjet që kanë të bëjnë me pakicat kombëtare, përkatësisht në Maqedoninë e Veriut, Serbi, Kroaci, Slloveni, Mal të Zi, Bosnjë dhe Hercegovinë, Bullgari dhe Shqipëri. (Stojanovska-Bizevska, A. 2021:2)

Komiteti për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive (analiza historike-cilësore)

Sipas Florian Bieber, ndikimi i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit (MKO) mbi marrëdhëniet ndëretnike, si dhe zbatimi i saj, mund të kuptohet përmes pesë dimensioneve: përfshirja, bashkëpunimi, autonomia, të drejtat e pakicave dhe pronësia shtetërore. Inkluzioni ishte një problem akut në administratën publike ku jomaqedonasit ishin të përfaqësuar në një numër shumë të vogël. MKO-ja siguron një mekanizëm të shpejtë me të cilin u ndryshua nënperfaqësimi. Theksi u vu edhe mbi rritjen e bashkëpunimit në nivel politik ndërmjet përfaqësuesve politikë të dy bashkësive dominuese, me qëllim të rritjes së ndikimit të faktorit shqiptar në procesin e vendimmarrjeve. Shtylla e tretë e MKO-së është decentralizimi më i madh i vetëqeverisjes lokale, që në një farë mënyre do të ishte rritje e autonomisë në procesin e vendimmarrjeve. Të drejtat e pakicave me MKO-në u përmirësuan dukshëm për të gjitha bashkësitë, dhe veçanërisht për bashkësinë shqiptare në fushën e përdorimit të gjuhës, që lidhet me përqindjen e popullsisë prej të paku 20% në nivel kombëtar ose lokal. Ndryshimi i pestë thelbësor me MKO-në është se Maqedonia nuk përkufizohet më vetëm si shtet kombëtar i popullit maqedonas, por lihet hapësirë që ajo të jetë e barabartë me të gjithë qytetarët (Bieber F., 2011: 17-20).

Në thelb, mekanizmat e përfshira në Marrëveshjen Kornizë në masë të madhe korrespondojnë me mekanizmat konsociale për organizimin e shoqërive multietnike, të përcaktuara nga politologu holandez Arend Lijphart në librin "Demokracija në shoqëritë pluraliste" (Lijphart, A. 1977). Sipas politologut Brendan Oliri: "Konsocializmi është qasja e preferuar e Kombeve të Bashkuara, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian në lidhje me përmbajtjen e marrëveshjeve paqesore" (Petkovski, A. 2013:3).

Komiteti për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive përfshihet ndër mekanizmat e përmendur paraprakisht. I formuar për të shqyrtuar çështjet lidhur me marrëdhëniet

ndërmjet bashkësive etnike në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe për t'i dhënë Kuvendit mendime dhe propozime për zgjidhjen e tyre. Komiteti është organ unik parlamentar anëtarë të të cilit janë përfaqësuesit e të gjitha bashkësive etnike të përfshira në Preambulën e Kushtetutës, ku deputetët dhe anëtarët e tjerë kanë mundësinë në një përbërje prej 19 anëtarësh të fokusohen në çështje nga fusha e marrëdhënieve ndëretnike. Krahas kësaj, Komiteti për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive ka edhe një autorizim tjetër të rëndësishëm, i cili i referohet vendimit lidhur me nevojën e zbatimit të procedurës së votimit në Kuvend me shumicë të dyfishtë (e njohur si "shumica e Badinterit").

Komiteti për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive, që nga nënshkrimi i MKO-së dhe miratimi i ndryshimeve kushtetuese që dolën prej tij, është ka qenë objektiv i kritikave serioze nga disa intelektualë. Profesoresha nga Fakulteti Juridik, Dr. Gordana Siljanovska - Davkova, pa elaborim analitik, dhe ndoshta tendencioz, konsideron se Komiteti paraqet një hap drejt krijimit të "shtëpisë së dytë" në kuadër të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, përkatësisht organ që do t'i përfaqësojë bashkësitë etnike. Të them të drejtën, pas 20 vitesh nga formimi i KMNB-së, ai nuk është bërë "shtëpi e dytë" në Kuvend. Autorja e njëjtë e kritikon përfaqësimin proporcional të deputetëve maqedonas dhe shqiptarë dhe dominimin e tyre numerik në raport me deputetët e bashkësive tjera (Nikollovaska dhe Siljanovska - Davkova, 2001). Siljanovska - Davkova i kundërshton dispozitat kushtetuese sipas të cilave parashihet që deputetët në rolin e anëtarëve të Komitetit, faktikisht t'i japin vetvetes mendime dhe propozime kur të vendosin për to në seancë plenare të Kuvendit. Përfundimisht, Siljanovska - Davkova e kundërshton vendimin sipas të cilit në rast të kontestit për zbatimin e procedurës së votimit në Kuvend, Komisioni vendos nëse votimi do të jetë me shumicë të dyfishtë. Siljanovska - Davkova, duke iu referuar qëndrimit të Komisionit Evropian për Demokraci përmes të drejtës, thotë se për kontest procedural nuk mund të vendosë organi politik, por gjykata, dhe për këtë sugjeron që çështja e aplikimit të procedurës së votimit në Parlamentin duhet të jetë nën kompetencën e Gjykatës Kushtetuese. (Petkovski, A. 2013: 255)

Ligji për Komitetin për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive (Gazeta zyrtare e Republikës së RM-së nr. 150/2007) përmban një listë me dyzet ligje të renditura me emër, miratimi ose ndryshimi i të cilave mund të bëhet vetëm përmes votimit, ku krahas shumicës së paraparë të deputetëve, propozimi do të mbështetet edhe nga shumica e deputetëve që u përkasin bashkësive joshumicë (votimi i Badinterit). Në Ligjin për Komitetin parashihet procedura e votimit me shumicë të dyfishtë të zbatohet për miratimin ose ndryshimin e të gjitha ligjeve të ardhshme që kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhëve, arsimin, dokumentet personale, kulturën dhe përdorimin e simboleve. Përfundimisht, në Ligjin për Komitetin është përcaktuar se Komiteti nuk ka të drejtë të vendosë sërish apo të ndryshojë vendimin e vendosur për çështje të caktuara.

Në përbërjen e tij të parë, Komiteti ka trajtuar tema të rëndësishme për marrëdhëniet ndëretnike, si për shembull Ligji për themelimin e universitetit shtetëror në Tetovë ose propozimi për miratimin e Ligjit për përdorimin e flamujve të bashkësive, por në anën tjetër Komiteti nuk ka diskutuar çështje me ndikim të veçantë në marrëdhëniet ndëretnike, siç janë ngjarjet në lidhje me Ligjin për ndarjen territoriale dhe referendumin lidhur me pranimin e tij apo tensionet ndëretnike që lindën si rezultat i ndryshimit të

emrit të shkollës në fshatin Shemshovë të Komunës së Jegunovcës dhe përleshjet e shpeshta mes nxënësve maqedonas dhe shqiptarë në Tetovë, Kumanovë dhe Shkup që vijuan si pasojë (Petkovski, A. 2013:259).

Në mandatin e dytë të Komitetit, ka pasur rast të një tendence për të siguruar kontrollin e votave të shumicës në Komitetin, përmes prononcimit të deputetes nga shumica qeveritare si anëtare e bashkësisë etnike vllahe dhe përfshirjes së saj në punën e Komitetit, pa u deklaruar paraprakisht si pjesëtare e asaj bashkësie. Edhe krahas asaj që procedura e përmendur e deputetes nuk ka qenë në kolizion me të drejtën, ajo ka ndikuar mbi cenimin e besimit dhe ka shkaktuar protesta të fuqishme të opozitës. Gjithashtu, në mandatin e dytë, bojkoti ka qenë instrument më shpesh i përdorur në kushtet kur anëtarët e Komitetit kanë dashur ta shmangnin ose prolongojnë debatin për ndonjë nga pikat e rendit të ditës. Komiteti në periudhën 2006 - 2008 nuk ka mbajtur asnjë nga mbledhjet e parapara për shkak të mungesës së kuorumit, ndërsa në periudhën 2006 - 2011 as 7 seanca nga gjithsej 18 nuk janë mbajtur ose janë ndërprerë për shkak të mungesës të kuorumit. Në disa raste, ministrat e ftuar nuk iu përgjigjën ftesave për të marrë pjesë në mbledhjet e Komitetit, ose u ato janë larguar menjëherë pas fjalimit të tyre. Në të njëjtin drejtim, deputetët e opozitës shpesh aludojnë se pushteti ekzekutiv dorëzon informacione të paplota në rastet kur Komiteti ka kërkuar dorëzimin e tyre. I tillë është rasti me informacionin e kërkuar nga MPB-ja për ngjarjet në Kalanë e Shkupit në vitin 2011. Në kontekst të ndikimit të politikës, ish-deputeti në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe politikan me eksperiencë – Ismet Ramadani, konsideron se: *Problemet ndëretnike janë tepër të pranishme në shumë sfera të jetesës së përditshme. Në kushte të politizimit të gjithçka si nga ana e politikanëve ashtu edhe nga qytetarë tjerë. Në rrethana të tilla Komiteti nuk është në gjendje që të ndikojë më seriozisht mbi krijimin e hapësirës së tolerancës ndëretnike, veçanërisht ndërmjet të rinjve nga bashkësi të ndryshme etnike* (Petkovski, A. 2013:257).

Në mbledhjen e tretë, Komiteti ka shqyrtuar çështjet që kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë mbi marrëdhëniet ndëretnike, si për shembull: diskutimi për gjendjet në arsim, në lidhje me vendimin e qeverisë për mësimin e gjuhës maqedonase për nxënësit e komuniteteve joshumicë të klasës së parë; diskutimi në lidhje me Ligjin për regjistrim ose diskutim për informacionin, të MPB-së për ngjarjet e Kalasë së Shkupit dhe ndikimin e tyre në marrëdhëniet ndëretnike dhe ndërfitare në Republikën e Maqedonisë. Në anën tjetër, edhe përkundër disa tentativave, kryetari i Komitetit nuk ka arritur të sigurojë kuorum për mbajtjen e mbledhjes, në të cilën është dashur të diskutohej për ndikimin e projektit “Shkupi 2014” në marrëdhëniet ndëretnike. Komiteti asnjëherë nuk ka diskutuar për përmbytjen e Enciklopedisë së botuar nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë, e cila shkaktoi protesta të partive politike dhe organizatave qytetare në të cilat janë anëtarë të bashkësisë etnike shqiptare. Rezultatet tregojnë se një numër i caktuar anëtarësh të Komitetit (pa përjashtim nga radhët e opozitës) kanë drejtuar kritika serioze ndaj Komitetit dhe kryetarit të tij në drejtim të reagimit të vonuar, shmangies së diskutimit për një temë të caktuar ose diskutime joefektive dhe diskutim për pasojat në vend të veprimeve parandaluese (Radio Evropa e Lirë, 2010).

Në periudhën nga viti 2002 deri në vitin 2009, tensionet politike të Kuvendit u pasqyruan në Komitetin. Siç sqaron profesori dr. Renata Treneska - Deskoska, ka funksionuar si

“Parlament i vogël” dhe i ka munguar autorizimi për debat të drejtpërdrejtë për çështje kritike të cilat ndoshta i kanë tensionuar lidhjet mes partnerëve të koalicionit në Qeveri. Gjatë kësaj periudhe, disa situata përbënin rrezik të madh për marrëdhëniet ndëretnike, si: problemet me arsimin në shkollat etnikisht të përziera në komunën e Strugës, iniciativa për ndërtimin e kishës në sheshin e qytetit të Shkupit, botimi i Enciklopedisë maqedonase nga Akademia e Shkencave dhe Arteve e Maqedonisë etj. Asnjë nga këto çështje nuk ishte në agjendën e Komitetit për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive. Në këtë kohë, Komiteti më shumë ishte një komitet teknik, përgjegjësia kryesore e të cilit ishte të vendosë për procedurën e votimit të ligjeve në Kuvend. Publiku nuk e njeh Komitetin për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive si organ për dialog ndëretnik dhe promovimin e ideve të tolerancës dhe ndërtimit të besimit ndërmjet bashkësive. Arsytet për këtë variojnë nga mungesa e vullnetit politik për t’u përfshirë në një debat të hapur dhe konstruktiv për çështje të ndjeshme etnike, tek mungesa e të kuptuarit të rëndësisë dhe domethënies së mandatit të këtij organi, si dhe mungesa e kapaciteteve institucionale për të mbështetur këtë organ në ekzekutimin e tij të plotë të kompetencave të tij. (Treneska – Deskoska R., 2010:77).

Në mbështetje të konstatimeve paraprake, deputeti Oliver Spasovski në mbledhjen e pestë të Komitetit në vitin 2012 e kritikon punën dhe efektet e punës së Komitetit duke thënë se: *“...bëhet e qartë se puna e Komitetit nuk jep rezultate në drejtim të tejkalimit të problemeve në marrëdhëniet ndërmjet bashkësive, para së gjithash për shkak të asaj që Komiteti nuk punon në parandalimin por gjithmonë diskuton vetëm për pasojat pasi tashmë të ketë ndodhur dëmi...”* (Petkovski A. 2013: 260).

Për pasivitetin e Komitetit në periudhën nga muaji prill 2014 deri në muajin qershor 2016 është theksuar edhe dokumentin i quajtur “Aktiviteti i deputetes – detyrë ose zgjedhje”, i cili është produkt i hulumtimit të Institutit për demokraci – Societa Civilis, në të cilin thuhet se në periudhën e vëzhgimit janë mbajtur vetëm 3 mbledhje të fokusuara në çështje teknike: Zgjedhja e kryetarit dhe nënkryetarit, përcaktimi i Agjendës së aktiviteteve për vitin 2015, shqyrtimi i Propozim-Programit për punë, si dhe informacioni për zbatim dhe realizim të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit të përgatitur nga Sekretariati për zbatimin e MKO-së, e për të cilën nuk ka pasur diskutim (Reçica V. 2017:7).

Disa nga të anketuarit²³ kanë theksuar se, megjithëse Komiteti është një strukturë juridike në përputhje me Kushtetutën dhe rregullativën ligjore i mungon fuqia politike e nevojshme për të përmbushur detyrat e tij. Nuk shqyrtohen raportet nga institucionet shtetërore si Ministria e Sistemit Politik dhe Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive, Avokati i Popullit, Agjencia për Realizimin e të Drejtave të Bashkësive, Ministria e Kulturës dhe institucionet tjera që merren me mbrojtjen e të drejtave të bashkësive në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Faktorët politikë u treguan si më me ndikim dhe kryesorë mbi punën e Komitetit. Ky është organi i vetëm në Parlament ku bashkësitë më të vogla etnike mund të punojnë së bashku për të ndikuar në politikë, por ato nuk kanë fuqi të mjaftueshme politike. Të anketuarit kanë theksuar se anëtarët e bashkësisë

23 Janë intervistuar deputetë që janë anëtarë të Komitetit për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive (2020-2024) Arbana Pasholli (kryetari i Komitetit) pjesëtare e bashkësisë etnike shqiptare; Zeqir Ramçilloviq (pjesëtar i bashkësisë etnike boshnjake); Lupço Ballkoski (pjesëtar i bashkësisë etnike vllahe); Enes Ibrahim (pjesëtar i bashkësisë etnike turke); Latifa Shikoska (pjesëtar i bashkësisë etnike rome).

maqedonase dhe bashkësisë shqiptare, në Komitetin janë dominues në vendimmarrje. Ata e theksojnë nevojën për të diskutuar për të gjitha vendimet me bashkësitë tjera me qëllim për ta ruajtur nivelin demokratik. (Zemon, A. 2022:15)

Për pyetjen sa shpesh Komiteti ka diskutuar për miratimin, ndryshimin ose plotësimin e legjislativit për të cilin votohet sipas “Badenterit”, përgjigjja ka qenë se praktikisht asnjëherë nuk ka pasur iniciativë për të organizuar mbledhje e tillë.²⁴. Anëtarët e Komitetit janë takuar edhe me përfaqësues të bashkësive “tjera” etnike që nuk janë përmendur në Kushtetutën, që sugjeron se kjo përbërje e Komitetit tregon interes për nevojat e atyre bashkësive, që është në frymën e procesit negociues për anëtarësimin e vendit në BE, si dhe me ndryshimet e paralajmëruara kushtetuese që duhet të vijojnë në periudhën e ardhshme.

Është interesante të vërehet se Komiteti asnjëherë nuk i ka rishikuar ose kontrolluar rezultatet nga konkluzionet dhe rekomandimet e tyre. Në fakt, konkluzionet dhe rekomandimet e Komitetit janë të natyrës deklarative dhe as Kuvendi as cilido institucion tjetër nuk ka vepruar në pajtim me to (Zemon, A. 2022:15).

Për në fund duhet të shënohet edhe ajo se në punën 20 vjeçare të Komitetit për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive, të gjithë kryetarët(et) kanë qenë edhe të bashkësisë etnike shqiptare. Ky fakt tregues, tregon se ky funksion sikur është i rezervuar vetëm për një bashkësi, e me atë është marginalizuar ose është joatraktiv për maqedonasit, të cilët gjithashtu kanë 7 anëtarë në Komitetin. Sipas nenit 6 të Ligjit për Komitetin për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive, Komiteti nga radha e anëtarëve të tyre, sipas parimit të rotacionit çdo vit zgjedh kryetar dhe zëvendëskryetar. Megjithatë, praktika e deritanishme e punës, ky parim i rotacionit, asnjëherë nuk është zbatuar në asnjë mandat të Komitetit.

Konkluzion dhe rekomandime

Si konkluzion, mund të thuhet se kontributi i Komitetit për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive në avancimin e marrëdhënieve ndëretnike nuk është i konsiderueshëm. Ky konkluzion bazohet, para së gjithash, në faktin se Kuvendi nuk ka vepruar sipas konkluzioneve të Komitetit. Ndikimi i partive politike dhe politikave të tyre është dominues, dhe përkatësia partiake dhe të qenët konsekuent në ndjekjen e direktivave partiake e paracakton punën e deputetëve si anëtarë të Komisionit për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive. Madje edhe në kushtet kur korniza juridike për punën e Komitetit u precizua me miratimin e Ligjit për Komitetin për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive (2007), bojkotimi i mbledhjeve nga anëtarët edhe më tutje mbeti mjeti më i përdorur për prolongimin e punës së Komitetit. Së këndejmi, në frymën e parimeve të demokracisë konsociacionale sipas Arent Lijphart, në rastin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, liderët politikë të segmenteve më të rëndësishme shoqërore luajnë rolin e Komitetit për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive kur ata reciprokisht merren vesh për parimet dhe fizionominë e marrëdhënieve ndëretnike.

24 https://www.sobranie.mk/2020-2024-aktivnosti-ns_article-sredba-na-komitetot-za-odnosi-megju-zaednicite-so-zdruzenijata-na-gragjani-na-zaednicite.nspx

Komisioni për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive ka rol të parëndësishëm në pjesëmarrjen efektive të bashkësive më të vogla etnike në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Gjithashtu, roli i tij në zgjidhjen dhe avancimin e marrëdhënieve ndërmjet bashkësive etnike në vend është shumë i vogël.

Përshtypja e përgjithshme është se çështjet për të cilat është i ngarkuar Komiteti diskutohen, miratohen konkluzione dhe vendime, ndërmerren konkluzione dhe vendime, të cilat më së shumti u drejtohen elitave politike në vend, si dhe se Komiteti nuk tregon kapacitet për të ndërmarrë iniciativë dhe për ta ndryshuar gjendjen e këtij organi të rëndësishëm që të mos marginalizohet në sistemin politik.

Që të përmirësohet funksionimi i Komitetit për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive, duhet të shqyrtohen çështjet për **kufizimin e ndikimit politik mbi Komitetin**, si dhe **rritjen e përfshirjes së bashkësive etnike me numër më të vogël**. Praktika e deritanishme tregon se deputetët në Kuvend nuk mund të ndahen nga identiteti i tyre partiak, rrallë marrin qëndrime ose vendosin si përfaqësues të qytetarëve nga bashkësitë etnike adekuate, nëse interesat e bashkësisë nuk janë unifikuar me qëndrimet partiake ose të koalicionit. Përkundrazi, ato vazhdimisht i japin prioritet mbrojtjes së interesave të partive politike, e sjellja e tillë është e dëmshme për integritetin dhe kredibilitetin e Komitetit për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive.

Me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes efektive të bashkësive më të vogla etnike të Maqedonisë së Veriut, si dhe të sigurimit se procesi i vendimmarrjes nuk reduktohet në vullnetin e shumicës maqedonase ose bashkësisë etnike shqiptare, duhet të **fusin ndryshime ligjore përkatëse**. Para së gjithash **Kodi Zgjedhor** mund të ndryshohet që t'u **mundësohet bashkësive etnike me numër më të vogël të zgjedhin përfaqësues në Kuvend**. Kjo mund të garantojë se mendimet e ndryshme në bazë të strukturës etnike në shoqërinë janë të përfaqësuara, pa dallim nëse Kuvendi do t'i votojë ligjet ose e mbikëqyrë pushtetin ekzekutiv, duke e bërë sistemin politik më demokratik. Mundësi tjetër janë **vendet e rezervuara në Kuvend**, të cilët u mundësojnë bashkësive etnike të kenë përfaqësim në dhomën legjislative pa dallim të rezultatit nga zgjedhjet parlamentare.

Komiteti në të ardhmen duhet të tregojë vullnet më të madh politik të përfshihet në **debat të hapur dhe konstruktiv për çështje të ndjeshme etnike**. Që të arrihet kjo nevojitet të rritet **vetëdija dhe kuptimi i rëndësisë dhe domethënies** së kompetencave të këtij organi, si dhe të **ngrihen në kapacitetet institucionale** për mbështetje të këtij organi në zbatimin e plotë të kompetencave të tij.

Neni 6 i Ligjit për Komitetin me të cilin përcaktohet se **kryetari** zgjidhet çdo vit me **parimin e rotacionit, duhet të fillohet të respektohet**, me ç'rast ky funksion do të fitojë diversitet etnik, e me atë edhe demokraci dhe diversitet më të madh në debatin e hapur konstruktiv për çështjet e ndjeshme etnike.

Përfundimisht, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, **kapacitetet institucionale për zbatimin e dispozitave ligjore**, si dhe vullneti politik për zbatimin e veglave për pjesëmarrje efektive të bashkësive më të vogla etnike, janë shumë të nevojshme.

BIBLIOGRAFIA

- **Bieber, Florian. 2011**, Assessing the Ohrid Framework Agreement, in: Risteska, Marija & Daskalovski, Zhidas (ed.) One Decade after the Ohrid Framework Agreement: Lessons (to be) Learned from the Macedonian Experience, Friedrich Ebert Stiftung and Center for Research and Policy Making, Skopje.
- **Јанев, Горан, 2005**, Автохтониот македонски мултикултурен модел, во: Мултикултурализмот во Македонија: Модел во настанување, ФИОМ, Скопје
- **Kymlicka, Will. 1995**, Multicultural Citizenship: A liberal Theory of Minority Rights, Oxford: Oxford University Press
- **Kymlicka, Will. 1999**, Etnički odnosi i zapadna politička teorija, во: Habitus broj 0, Novi Sad, достапно на (<http://www.cceol.com/aspx/issuedetails.aspx?issueid=f1193de4-2fc8-4f3b-8225-5aaf07b151fa&articleId=f83eab4e-2e7d-4455-9800-4bda96cf6202>)
- **Кимлицка Вил. 2004**, *Мултикултурно граѓанство*, Институт за демократија, солидарност и цивилно општество, Скопје
- **Lijphart, Arend. 1977**, Democracy in Plural Societies: A Comparative Exploration. New Haven, CT. Yale University Press
- **Петковски, Александар. 2013**, Улогата на Комитетот за односи меѓу заедниците – целисходност и перспективи, Универзитет „Гоце Делчев“, Штип
- **Николовска, Наталија & Силјановска-Давкова, Гордана. 2001**, Македонска транзиција во дефект: од унитарна кон бинационална држава. Скопје: Магор.
- **Радио Слободна Европа, март 2010**, Интервју со Џеват Адеми, претседател на Комитетот за односи меѓу заедниците (Disponueshëm në <https://www.slobodnaevropa.mk/amp/1989426.html>)
- **Речица, Влора. 2017**, Пратеничка активност- должност или избор, Краток документ за јавни политики, Институт за демократија Социетас Цивилис, Скопје (достапно на: <https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2017/02/%D0%9A%D1%80%D0%B0%D1%82%D0%BE%D0%BA-%D0%B4%D0%BE%D0%BA%D1%83%D0%BC%D0%B5%D0%BD%D1%82-%D0%B7%D0%B0-%D1%98%D0%B0%D0%B2%D0%BD%D0%B8-%D0%BF%D0%BE%D0%BB%D0%B8%D1%82%D0%B8%D0%BA%D0%B8%D0%9F%D1%80%D0%B0%D1%82%D0%B5%D0%BD%D0%B8%D1%87%D0%BA%D0%B0-%D0%B0%D0%BA%D1%82%D0%B8%D0%B2%D0%BD%D0%BE%D1%81%D1%82-%D0%B4%D0%BE%D0%BB%D0%B6%D0%BD%D0%BE%D1%81%D1%82-%D0%B8%D0%BB%D0%B8-%D0%B8%D0%B7%D0%B1%D0%BE%D1%80.pdf>)
- **Слободна ТВ, 2 февруари 2022**, Пашоли: Комитетот за односи меѓу заедниците треба да биде пример за сите граѓани во С. Македонија, (disponueshëm në: <https://slobodna.tv/utrinskibrifing/%D0%BF%D0%B0%D1%88%D0%BE%D0%BB%D0%B8-%D0%BA%D0%BE%D0%BC%D0%B8%D1%82%D0%B5%D1%82-%D0%B8%D0%B7%D0%B1%D0%BE%D1%80.pdf>)

[%D0%B7%D0%B0-%D0%BE%D0%B4%D0%BD%D0%BE%D1%81%D0%B8-%D0%BC%D0%B5%D1%93%D1%83-%D0%B7%D0%B0%D0%B5%D0%B4%D0%BD%D0%B8%D1%86/ \)](#)

- **Станковић Пејновић, Весна. 2016**, Амбивалетност мултикултурализма у Македонији, во: Становичић, Војислав & Башић Горан (ур.), Стање и перспективе мултикултурализма у Србији и државама региона, Зборник радова са научног скупа одржаног 10-11. Децембра 2015, САНУ и Институт друштвених наука, Београд
- **Стојановска- Бизевска, Александра. 2021**, Постоење, надлежности и форма на организација на Комитет за односи меѓу заедниците во избрани држави- компаративна анализа, Собрание на Република Северна Македонија, Парламентарен институт, Скопје
- **Тејлор, Чарлс. 2004**, Политика на признавање, во: Мултикултурализам- феврспраи огледи за политиката на признавање, Евро-Балкан пресс, Скопје
- **Тодоровиќ, Драган. 2007**, *Друшћивена удаљеност од Рома (Еѿничко-релиѿијски оквир)*, Ниш и Нови Сад, Stylos
- **Treneska- Deskoska, Renata. 2010**, Committee and Commissions for Inter-Community Relations as Instruments for Inter-Ethnic Dialogue in the Republic of Macedonia." *Pravo zemalja u regionu*. Institut za uporedno pravo, Beograd, 74-88
- **Zemon, Amona. 2022**, Effective participation of the smaller ethnic communities in the Assembly of North Macedonia, seminar paper, University of Graz, Graz
- **Zemon, Rubin. 2018**, Macedonian Salad: Managing of Virtual Reality among the Imagining of the Nation – State, Dreaming Multiculturalism and Developing Bi-Cultural Policies, u: *Multiculturalism in Public Policies*, Academic Network for Cooperation in South- East Europe, Institute for Social Sciences, Beograd, Institute for Ethnic Studies, Ljubljana and Centre for International and Security Studies, Faculty of Political Studies, Zagreb
- **Zemon, Rubin. 2021**, Republika Severna Makedonija između etničke demo-kratije i koncepta "Jedno Društvo", *Kulturna autonomija nacionalnih manjina u svetlu činjenica* (str. 168–187). Beograd: Institut društvenih nauka.

Ana Çupeska ka lindur në Shkup në vitin 1981, profesorësh inoordinare në Fakultetin e Shkencave Politike në Fakultetin Juridik “Justiniani i Parë” në UCDHEM në Shkup, ku njëkohësisht është edhe udhëheqëse e kolegjiut master të shkencave politike. Si doktor i shkencave politike dhe magjistër i shkencave në fushën e politikës ndërkombëtare, interesi i saj shkencor është rreth çështjeve për multikulturalizmin, të drejtat specifike grupore dhe konfliktet e identiteteve, demokracinë e populizmit, si dhe marrëdhëniet politike ndërkombëtare. Ajo është anëtare e këshillit shkencor në Fondacionin Evropian për Politika Progresive (FEPS) me seli në Bruksel. Është redaktore në disa zhurnalë akademikë ndërkombëtarë. Është autore e disa librave dhe botimeve në fusha shkencore dhe profesionale përkatëse.

Rizvan Sulejmani ka lindur në fshatin Lubin, Shkup 1957, profesor në Universitetin “Nëna Tereza” në Shkup, ish-ministër i Vetëqeverisjes Lokale dhe zëvendësministër i Mbrojtjes, si dhe ish-drejtor i Institutit për Studime Politike dhe Multikulturore. Në periudhën nga viti 1996 deri në vitin 2002 Sulejmani ishte deputet në Parlamentin e Maqedonisë në Parlamentin e NATO-s. Ka qenë edhe anëtar i Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi, si dhe ka marrë pjesë në shumë komisione, trupa punuese lidhur me politikën e multikulturalizmit në vend dhe jashtë vendit.

Rubin Zemon ka lindur në Strugë në vitin 1970, doktor i etnologjisë ose antropologjisë sociokulturore, drejtor i Qendrës për Kërkime të Avancuara nga Shkupi. Këshilli i Evropës, si dhe OSBE/ODIHR-ja disa herë e kanë angazhuar si ekspert/konsulent për misione, projekte dhe çështje të ndryshme lidhur me pakicat kombëtare dhe multikulturalizmin, në vende të ndryshme evropiane, veçanërisht në vendet e Evropës Juglindore. Në vitin 2018 emërohet si këshilltar i posaçëm i Kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për zhvillim të shoqërisë multikulturore, ndërkulturalizmit dhe komunikimeve ndërkulturore. Nga ajo pozitë e inicioi dhe fillimisht e udhëhoqi përgatitjen e Strategjisë kombëtare qeveritare për zhvillim të konceptit për një shoqëri dhe ndërkulturalizëm. Në periudhën 2019-2020 ishte deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

